



Sfida për përmirësimin e mësimit online

Mbështetur nga:



Ky botim është përgatitur në kuadër të projektit të Forurit Shqiptar Social Ekonomik – ASET “Sfida dhe ide inovative për përmirësimin e mësimin online në kushtet e COVID-19” i financuar nga Agjencia për Mbështetjen e Shoqërisë Civile – AMSHC.

© **Forumi Shqiptar Social Ekonomik**

Numir i kopjeve: 400

Punoi: Elena MYFTARAJ dhe Eglantina ZYKA

Koordinatori kryesor: Elvi MEMAJ

Koordinatorë (në rendin alfabetik):

Ajkuna MUJO HAJTI, Alba SKËNDAJ, Arjeta VESHI, Elmira KUSHA, Emil FRASHËRI, Eralda ZHILLA, Jonida BIÇOKU, Kledia ARGJIRI (TIRANA), Ledina ALOLLI, Migena MUSALLARI, Valbona HABIL, Zamira SINAJ

Tiranë, Janar 2021

Përmbajtja

Metodologjia	5
Korniza e zgjedhjes	6
Rishikim i literaturës	7
Analiza e të dhënave.....	15
Analiza e të dhënave të grumbulluara nga përgjigjet e studentëve	15
Analiza e të dhënave të grumbulluara nga përgjigjet e pedagogëve.....	29
Konkluzione dhe rekomandime	41
Konkluzione nga informacioni i marrë nga pedagogët.....	41
Konkluzione nga informacioni i marrë nga studentët	42
Rekomandime për pushtetin qendror dhe vendor.....	43
Rekomandime për universitetet dhe pedagogët.....	44
Rekomandime për studentët.....	44
Referenca	45
Figura 1: Ilustrimi i metodologjisë.....	6
Tabela 1: Karakteristikat socio-demografike dhe shpërndarja gjeografike e studentëve.....	15
Tabela 2: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas efektivitetit të metodave të ndryshme të përdorura për zhvillimin e leksioneve <i>online</i>	20
Tabela 3: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas nivelit të vështirësive gjatë mësimit <i>online</i>	23
Tabela 4: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas opinionit për deklarata lidhur me mësimin <i>online</i>	25
Tabela 5: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas vlerësimit të avantazheve të mësimit <i>online</i>	28
Tabela 6: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas vlerësimit të disavantazheve të mësimit <i>online</i>	28
Tabela 7: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas mënyrave të fitimit të njohurive.....	34
Tabela 8: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas arsyes së përzgjedhjes së metodës së mësimit <i>online</i>	34
Tabela 9: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas përgatitjes për mësim <i>online</i>	34
Tabela 10: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas rëndësisë së digjitalizimit	34
Tabela 11: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas metodës së mësimdhënies ku ndihet më komod ..	35
Tabela 12: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas eksperiencës prej mësimit <i>online</i>	35
Tabela 13: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas opinionit për disa çështje	36
Tabela 14: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas përgjigjeve për pyetjen “Çfarë ju ka surprizuar më shumë gjatë mësimit <i>online</i> ?”	36
Tabela 15: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas përdorimit në vazhdim të mësimit <i>online</i>	37
Tabela 16: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas arsyeve të vështirësive	37
Tabela 17: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas platformave të përdorura.....	38
Tabela 18: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas paisjeve të përdorura	38
Tabela 19: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas mendimeve për përmirësim.....	38
Tabela 20: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas sfidave të përballuara.....	39
Grafik 1: Shpërndarja e pyetsorëve sipas niveliti të tyre të studimit.....	15
Grafik 2: Shpërndarja e studentëve sipas zonës së banimit.....	16
Grafik 3: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas pajisjeve të përdorura për të ndjekur mësimin <i>online</i> ..	16
Grafik 4: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas aftësive në teknologjinë e informacionit.....	17

Grafik 5: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas aksesit në internet për leksione, seminare dhe studim të pavarur	17
Grafik 6: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas kostos mesatare mujore të internetit për zhvillimin e mësimin <i>online</i>	17
Grafik 7: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas të paturit e një hapësire të qetë për të mësuar e ndjekur mësimin <i>online</i>	18
Grafik 8: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas angazhimit në punë.....	18
Grafik 9: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas formave të ndryshme të përdorura për të zhvilluar mësimin <i>online</i>	19
Grafik 10: A ndiqej në të gjitha lëndët e njëjta mënyrë e mësimin <i>online</i> ?.....	20
Grafik 11: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas metodave më të aplikuara për mësimin online	21
Grafik 12. Çfarë bëni kryesisht gjatë leksioneve <i>live</i>	22
Grafik 13: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas kufizimeve që lidhen me ndjekjen 100% të mësimin <i>online</i>	22
Grafik 14: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas mënyrës së zhvillimit të seminareve gjatë mësimin <i>online</i>	24
Grafik 15: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas efektivitetit të mësimin <i>online</i> në raport me mësimin tradicional të zhvilluar në fakultet.....	26
Grafik 16: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas opinionit se çfarë do të donin të ndryshonte në mësimin <i>online</i>	26
Grafik 17: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas kënaqësisë nga ndërthurja e seminareve me leksionet gjatë mësimin <i>online</i>	26
Grafik 18: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas nxitjes nga pedagogu i diskutimit dhe mendimit kritik gjatë mësimin <i>online</i> ?	27
Grafik 19: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas përputhjes që përmbajtja e tezave në provime kishte me mësimin <i>online</i>	27
Grafik 20: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas krijimit nga pedagogët e një klime të përshtatshme dhe mbështetëse për studentët në zhvillimin e ideve të reja	27
Grafik 21: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas IAL-ve	29
Grafik 22: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas gjinisë.....	30
Grafik 23: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas moshës	30
Grafik 24: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas vendit të zhvillimit të mësimin	30
Grafik 25: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas numrit të orëve javore	30
Grafik 26: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas eksperiencës për mësim <i>online</i>	31
Grafik 27: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas numrit të lëndëve <i>online</i>	31
Grafik 28: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas njohurive të mëparshme për mësimin <i>online</i>	32
Grafik 29: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas rritjes së njohurive për mësimin <i>online</i>	32
Grafik 30: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas udhëzimeve të marra për mësimin <i>online</i>	32
Grafik 31: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas kuptueshmërisë së udhëzimeve	33
Grafik 32: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas vështirësive të organizimit të mësimin <i>online</i>	33
Grafik 33: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas vështirësisë së organizimit të mësimin <i>online</i>	37

Metodologjia

Ky studim fillon me një rishikim të literaturës dhe raporteve të disponueshme. Prandaj, përmes këtij instrumenti ekipi i projektit ka mbledhur dhe analizuar informacionin ekzistues, të dhënat dhe raportet të mëparshme (të dhëna dytësore) dhe të dhënat e marra nga universitetet, botime nga institucione qeveritare dhe joqeveritare, raporte dhe studime të disponueshme në internet, gazeta dhe revista profesionale, raporte nga organizata ndërkombëtare, etj.

Kjo fazë e mbledhjes së të dhënave dhe rishikimit të literaturës është faza e parë të studimit si një kërkim fillestar dhe ka qenë mjaft e dobishme sepse na ka ofruar njohuri më të thelluara për këtë problem dhe na ka ndihmuar që të marrim më shumë informacion nga kërkimi shkencor. Ekipi i projektit e ka përdorur këtë fazë si pikënisjen e problemeve dhe arritjeve nga mësimi *online* në kënvështrimin e të gjithë palëve të interesuar. Për më shumë rreth literaturës së studiuar dhe burimet e përdorura për këtë raport shikoni burimet e listuara në bibliografinë e punimit.

Teknika sasiore

Brenda kornizës së këtij projekti u realizuan 2 vrojtime me pyetsorë, përkatësisht: a) një vrotim me studentë në IAL publike dhe private; dhe b) një vrotim me personelin akademik në IAL publike dhe private. I pari nga këto instrumente synon të grumbullojë të dhëna statistikore për të analizuar sfidat me të cilat përballen studentët gjatë mësimit *online* nga pikëpamja e mësim-nxënies. Vrojtimi i dytë e trajton problemin nga këndvështrimi i pedagogëve përmes mësimdhënies *online*.

Procedurat e ndjekura

Të dhënat statistikore të grumbulluara nga vrotimi i pedagogëve dhe i studentëve janë grumbulluar përmes vrotimit me pyetsorë online. Fillimisht u vendos që zgjedhja të formohej si një zgjedhje e kombinimit midis zgjedhjes së rastit me zgjedhjen në seri duke e bërë këtë gjë përmes këtyre hapave:


1. U zgjodhën në mënyrë të rastit universitetet që do të ishin pjesë e vrotimit. Nga zgjedhja na rezultoi se vrotimi duhet të realizohej në 4 universitete publike (Universiteti i Tiranës, Universiteti i Elbasanit, Universiteti i Korçës dhe Universiteti i Vlorës) si dhe 3 IAL jopublike (Luarasi, Mesdhetar dhe Metropolitan).
2. Në secilën universitet u zgjodhën 2 fakultete
3. Me anë të zgjedhjes së rastit u përzgjedhën grupet mësimor që u vrojtuan për sfidat e mësimit *online* (në studim u përzgjedhën grupe mësimore që aktualisht ndodhen në vitin e dytë dhe të tretë në nivelin bachelor në vitin e dytë të studimeve master. Në secilën degë dhe vit u zgjodhën nga 2 grupe.
4. Çdo grup i zgjedhur u konsiderua si një seri e zgjedhur për shkak se ne tentuam të marrim përgjigje nga të gjithë studentët e grupit. Në bazë të përgjigjeve të marra u llogarit norma e refuzimit.

Përpunimi i të dhënave dhe Analiza Statistikore

Mbas ndërtimit të databazës, të dhënat statistikore të grumbulluara janë hedhur në databazë të koduara dhe janë përpunuar në SPSS 20 dhe Excel. Pasi të dhënat e hedhura në databazë u pastruan dhe kontrolluan për qëndrueshmërinë e tyre, procedura vazhdoi me analizën e të tyre. Të gjitha vlerat janë testuar për rëndësinë statistikore dhe nivelin e intervalit të besimit prej 95% me testet e duhura statistikore.

Figura e mëposhtme ilustron metodologjinë për kryerjen e studimit.

Figura 1: Ilustrimi i metodologjisë



Korniza e zgjedhjes

A. Madhësia e zgjedhjes për studentët është formuar mbas provës pilot dhe është e përbërë nga kompozimi në 7 universitete * 2 fakultete * 3 vite të ndryshme të studimit * 2 grupe mësimore = 56 grupe mësimore (seri statistikore). Duke marrë numrin e studentëve në secilin nga këto grupe krijuam një zgjedhje me 1502 studentë. Koordinatorët në universitete informuan dhe nxitën studentët për të plotësuar pyetsorin *online*.

B. Madhësia e zgjedhjes për pedagogët u krye përmes zgjedhjes së rastit duke bërë më parë provën pilot. Nga llogaritja e numrit të nevojshëm të vrojtimit rezultoi se duheshin vrojtuar nga 35 pedagogë nga secili universitet i përzgjedhur, pra gjithsej 245 pedagogë. Koordinatorët në universitete informuan dhe nxitën pedagogët e përzgjedhur për të plotësuar pyetsorin *online*.

Vrojtimi *online* nën kujdesjen e koordinatorëve të zgjedhur në secilin universitet vazhdoi për tre javë (26 Tetor - 15 Nëntor, 2020).

Rishikim i literaturës

Pandemia e *Covid-19* në mbarë botën ka prekur zhvillimin e mjaft sektorëve si atë të shëndetësisë, ekonomisë, levizjen e lirë të njerëzve, arsimit në të gjitha nivelet e tij. Referuar raportit të OCDE për 2020, aktiviteti ekonomik global pritet të bjerë me 6 % në 2020 dhe norma mesatare e papunësisë në vendet e OCDE të arrijë në 9.2% nga 5.4 në 2019.

Një ndikim të madh kjo pandemi ka patur edhe në zhvillimin e arsimit. Nisur nga situata pandemike e krijuar këtë vit shumë qeveri u detyruan të bëjnë mbylljen totale, gjë e cila solli ndryshime në mënyrën e të punuarit dhe të mësuarit në universitete. UNESCO ka vlerësuar se në 177 vende janë mbyllur shkollat si një masë parandaluese mbrojtëse nga *Covid-19*, duke prekur 1,268,164,088 mësimnxënës në gjithë globin. (UNESCO, 2020). Ndërkohë referuar raportit të UN 2020, pandemia e *Covid-19* ka shkaktuar përçarjen më të madhe të sistemit arsimor në histori, duke prekur rreth 1.6 bilion mësimnxënës në më shumë se 190 vende në të gjithë botën. Mbyllja e shkollave ka prekur 94% të studentëve në të gjithë botën dhe 99% të studentëve në vendet me të ardhura mesatare e të ulta. Aftësia për tju përgjigjur mbylljes së shkollave është ndikuar shumë nga niveli i zhvillimit të vendit: në 3-mujorin e dytë të 2020, 86 % e nxënësve në shkollat fillore të vendeve me zhvillim të ulët kanë mbetur jashtë sistemit arsimor krahasuar me vetëm 20 % në vendet me zhvillim shumë të lartë njerëzor.

Sipas një raporti të ILO (2020), mbi ndikimin tek të rinjtë të *Covid-19*, në tregun e punës, arsim, të drejtat dhe shëndetit mendor, ku ishin përfshirë 12605 të rinj të moshës 18-34 vjeç nga 112 vende të botës, mbi 73% e të rinjve u ndikuan nga mbyllja e shkollave, universitetet apo qendrave të trajnimit. Ky efekt ishte pak më i lartë tek ata të cilët vetëm studionin (74%), krahasuar me ata të cilët studionin dhe punonin. Përqindje më të lartë të mosndjekjes së kurseve gjatë mbylljes nga pandemia kanë raportuar të rinjtë të cilët jetojnë në vende me të ardhura të ulta. 65% e të rinjve nga vendet me të ardhura të larta mësuan në klasa me video-leksione, në vendet me të ardhura të ulta kjo mënyrë e të mësuarit ishte deklaruar nga 18% e të rinjve. Sipas këtij raporti arsyet që pengonin efektivitetin e mësimit *online* janë: 1. Nivel i ulët i aksesit në internet, 2. Aftësi të pamjaftueshme digjitale për të mësuar nga distanca, 3. Mungesa e pajisjeve IT, 4. Mungesa e hapësirës, 5. Mungesa të materialeve të përshtatshme për të dhënë mësim në distancë, si dhe 6. Mungesa e grupeve të punës dhe të kontaktit social.

Masat e izolimit si pasojë e kësaj pandemie sollën sfida të reja në procesin e mësimdhënies, ku burimet digjitale kanë një rol kryesor për të përballuar këtë situatë. Mësimi *online* u pa si alternativa më e mirë për të vijuar transferimin e njohurive, por tani virtualisht nëpërmjet internetit. Në situata të tilla u përdor teknologjia e internetit për të komunikuar nëpërmjet e-maileve dhe formave të tjera të komunikimit të zhvilluara edhe në platforma komunikimi.

Zhvillimi i teknologjisë ka krijuar mundësinë që të përdoren teknika të ndryshme inovative për të bërë të mundur mësimin në distancë. Mësimi nëpërmjet internetit është një mundësi e mirë për përthithjen e njohurive të nevojshme për situata të tilla si ajo për shkak të *Covid-19*. Përpara mbylljes për shkak të *Covid-19*, kryesisht mësimi

nëpërmjet internetit ka qenë një mënyrë efektive për studentët të cilët e kishin të pamundur të marrnin pjesë në klasë. Më herët, nevojat që çuan në rritjen e përdorimit të mësimi *online* kanë qënë kryesisht ekonomike, lidhur me pamundësinë e studentëve për të ndjekur mësimin në klasat e tyre, sot ajo lindi si një nevojë e diktuar nga kushtet, për të mbrojtur shëndetin.

Ally (2008) përkufizoi termin mësim *online* si mënyrën e rritjes së njohurive të nxënësve, të cilët bazuar në teknologjinë e internetit mund të kenë akses në materialet mësimore, të ndërveprojnë me materialet, mësuesit dhe studentët përmes një rrjeti kompjuterik. Interneti është duke u bërë mjeti dominues për shpërndarjen e informacionit dhe njohurive për shkak të kostos së ulët dhe shpërndarjes së shpejtë të informacionit. Interneti është bërë një mënyrë e rëndësishme ditët e sotme për të shpërndarë dhe për të marrë informacion (Arkorful & Abaidoo, 2015). Aktualisht, shumë institucione arsimore e kanë shtuar mësimin nëpërmjet internetit jo vetëm në trajnime të ndryshme por edhe në zhvillimi e kurrikulave mësimore, veçanarisht në situatën e mbylljes totale për shkak të *Covid-19*.

Institucionet e arsimit të lartë dhe shkollat në vende të ndryshme pas fillimit të pandemisë, u përballën me sfida të reja të procesit të edukimit në distancë. Sipas Departamentit të Arsimit në Këshillin e Europës, në vende të ndryshme në Europë janë zhvilluar praktika të ndryshme të mësimi në distancë që kanë përfshirë programin sinkron të mësimi në distancë, i aksesueshëm nëpërmjet kompjuterave, tabletave, celularëve si edhe programeve asinkrone duke përdorur platforma të ndryshme *online*. Sipas raportit 2020 të OCDE me mbylljen e shkollave në mjaft vende, si një ndër masat izoluese të marra në mars të 2020, janë përdorur burime të ndryshme për të mbështetur mësimin për studentët si paketat udhëzuese (librashkollorë, fleta pune, printime), mësimi në radio dhe ne televizion si dhe burime udhëzuesish *online*. Në vendet e OCDE platformat *online* kanë qënë mjetet më të përdorura gjatë mbylljes së shkollave. (Schleicher and Reimers, 2020)

Mjetet e mësimi *online* të përdorura gjatë mësimi *online* kanë përfshirë si materialet edukative të cilat studentët mund t'i përvetësonin nëpërmjet leximit në mënyrë individuale ashtu edhe në mësimin në ~~real-time~~ kohë reale nga mësuesit e tyre nëpërmjet platoformave të takimeve virtuale. Në Francë, ku ekzistonin edhe më parë programe të mësimi në distancë “Mësimi në shtëpi”, u bë e vlefshme për të gjithë nxënësit e shkollave fillore dhe 9 vjeçare (Ministria e Rinisë dhe e arsimit, 2020). Në Greqi pati një ndërthurje të mësimi sinkron dhe asinkron (Ministry of Education and Religious Affairs, 2020; Schleicher and Reimers, 2020).

Në mjaft vende të OCDE programet televizive kanë qënë të përdorura sidomos për nxënësit e shkollave fillore (Greqi, Portugali) si edhe për studentë, të cilët nuk mund të kishin burimet e nevojshme për të patur akses në mësimin *online*. Në Luksemburg u ndërtua një system i veçantë nga qeveria për të mbështetur studentët dhe prindërit e nxënësve për mësimin në shtëpi (OECD, 2020).

Njihen dy forma përsa i përket mësimi *online*, mësimi hibrid (pjesërisht *online* dhe pjesërisht në klasa) dhe mësimi totalisht *online*. Sipas (Boelens R. et al. 2017) përdorimi i mjediseve të përziera (hibride) të të nxënët sjell në vetvete katër sfida

kryesore: 1-përfshirja e fleksibilitetit, 2- ndërveprimi stimulues, 3- lehtësimit i proceseve të të nxënësve të studentëve dhe 4-nxitja e një klime afektive të të mësuarit.

Përsa i përket platformave të mësimin *online*, shpesh i referohen tre formave: mjediset virtuale të të mësuarit (virtual learning environment, VLE), sistemet e manaxhimit të të mësuarit (learning management systems, LMS) dhe sisteme të manaxhimit të përmbajtjes ((Learning Content Management system, LCMS). VLE përdoren zakonisht për të stimuluar mësimin tradicional, si shembuj të këtyre platformave mund të përmendim Moodle 46 dhe Blackboard. 47. LMS, sipas Coates H. et al. janë platforma të cilat përfshijnë sisteme të të mësuarit, portale, sisteme të manaxhimit të institucioneve si dhe sisteme të manaxhimit të përmbajtjes. LMS lehtëson manaxhimin e njohurive duke përfshirë klasa *online* dhe virtuale si dhe kurse të drejtuara nga instruktorë. Të dyja këto platforma nuk kanë ndryshime por LMS përdoren kryesisht për trajnime dhe VLE për mësim. Platformat LCMS përdoren për të krijuar materiale me përmbajtje, të tilla si artikuj, teste, lojëra, video të cilat më pas grumbullohen, ripërdoren dhe përshtaten në kurse të ndryshme sipas nevojave të studentëve.

Në Shqipëri, në mars 2020 u mbyllën shkollat në të gjithë vendin si një masë parandaluese gjatë pandemisë. Ministria e Arsimit, Sportit dhe Shkencës publikoi udhëzuesit e mësimin në shtëpi në 30 mars 2020. Ministria e Arsimit, Rinisë dhe Sporteve për të mundësuar vazhdimësinë e mësimin online krijoi platformat *online* si Akademia.al (për nxënësit 3-18 vjeç) apo edhe kanale në youtube si dhe librarinë elektronike, Elektronik u- Librari (RASH). Dy forma kryesore mësimore që u aplikuan në vend gjatë 3-mujorit të dytë të 2020, ishin: mësimet të transmetuara në Radio Televizionin Shqiptar (RTSH) dhe puna nxënësve dhe mësues përmes rrjeteve sociale apo platformave të ndryshme që mundësojnë krijimin e klasave virtuale (si *Google Classroom*, *Zoom*, etj).

Referuar raportit të World Vision u prekën 652,592 mësimnxënës, nga të cilët 482,048 ishin fëmijë (World Vision, maj 2020). Ndryshimi i formës së mësimin çoi në një adaptim të sjelljes së mësimnxënësve, prindërve të tyre dhe mësimdhënësve, për tu përshtatur sa më shpejt formës së re, shumë e ndryshme nga forma tradicionale e mësimin në klasa e auditore.

Kjo mënyrë e re e funksionimit të mësimdhënies ndikoi në të gjithë aktorët e përfshirë në sistemin arsimor: institucionet arsimore, mësimdhënësit, studentët dhe nxënësit si dhe prindërit e tyre, aktorë të cilët janë faktorë kontribues në cilësinë e realizimit të mësimin në distancë. Përveç sfidave më të cilat u ndesh solli gjithashtu edhe mundësi të reja për aktorët e përfshirë në të. Disa prej mundësive të reja në këtë drejtim ishin: një urë e re komunikimi midis prindërve të nxënësve dhe mësuesve, komunikimi i vazhdueshëm midis mësimdhënësve për të ndarë eksperiencat e tyre, përvetësimi i mundësive të reja të mësimdhënies dhe rritje të kreativitetit në mësimdhënie (Petrie, et al., 2020).

Ka shumë faktorë që mund të ndikojnë në efektivitetin e mësimin *online*, siç janë lloji i lëndës, teknologjia e përdorur, karakteristikat e studentëve etj. Gamage, et al. (2014) identifikuan bazuar në një analizë cilësore dimensionet kryesore si ndikojnë në efektivitetin nga pjesëmarrësit: Teknologjia, Pedagogjia, Motivimin, lehtësia e

përdorimit, materialet, suporti për studentët, vlerësimi, orientimi për të ardhmen, bashkëpunimi, interaktiviteti. Sun (2016), theksoi se efektiviteti I të mësuarit *online* varet mënyra e paraqitjes së materialeve mësimore, angazhimi i lektorit në mjedisin *online*, si dhe ndërveprimi lektor-student dhe student-student.

Bao (2020), konkludoi në pesë parime me ndikim të lartë në arsimin *online*: 1. Rëndësia e madhe e planit të udhëzimeve dhe të mësuarit të studentëve, 2. Shpërndarja efektive e informacioneve udhëzuese, 3. Mbështetja e duhur nga ana e lektorëve për studentët, 4. Pjesëmarrja me cilësi të lartë për të përmirësuar njohuritë e studentit, 5. Plani i reagimit në rast të incidenteve të papritura në platformat e mësimit *online*.

Studimet kanë treguar se midis mësimit *online* dhe atij në klasë studentët kanë preferuar mësimin në klasë, por ndryshime statistike jo të rëndësishme midis të dy llojeve të mësimit (Kemp dhe Grieve, 2014). Sipas Liu (2010) mësimi *online* është pak më efektiv se mësimi klasik, por përse i përket mësuesve nuk kishte ndryshime të rëndësishme midis të dyja këtyre mënyrave të mësimit. Mësimi në distancë është si edhe mësimi në klasë përfshin lloje të ndryshme bashkëveprimesh si ato midis shumë studentëve dhe materialeve informative, midis studentëve e pedagogut të tyre dhe midis vetë studentëve. Dhawan (2020) sugjeron pranimin dhe përshtatjen me ndryshimet në mënyrën e të mësuarit, çka do të sillte inovacion, por pa harruar studentët të cilët nuk kanë mundësi për akses në internet apo i përkasin familjeve me të ardhura të kufizuara si dhe kostot e shtuara për shkak të pajisjeve shtesë dhe kostot e internetit. Sipas Dhawan (2020) ndarja digjitale mund të sjellë pabarazi.

Pavarësisht karakteristikave të përbashkëta të mësimit *online* dhe atij në klasë, lidhur me mësimin *online* ekzistojnë edhe problematika të lidhura me së shumti me anën logjistike. Mësimdhënia *online* kërkon shumë më shumë kohë përgatitje sesa mësimi në klasë, disa lloje të caktuara të materialeve mësimore mund të jetë shumë e vështirë për ti paraqitur në internet apo dhe për t'u mësuar nëpërmjet tij. Çështje të tjera të rëndësishme të lidhura me mësimin *online* që duhet të konsiderohen janë çështjet e konfidencialitetit dhe përgjegjësisë individuale ashtu si edhe siguria në Interneti e cila është një sfidë e vazhdueshme. Sidoqoftë, në situata të caktuara, mësimi nëpërmjet internetit është një alternativë e mundshme, e rëndësishme dhe e përdorshme në vend të mësimit tradicional në klasë. Madje në shumë raste, mësimi *online* mund të plotësojë ndjeshëm mësimin në klasë duke vazhduar të rritet si një pjesë e domosdoshme e arsimit akademik dhe profesional.

Për nxënësit me probleme, sipas raportit të UNESCO ka qënë e vështirë të përcaktohet numri i atyre që kanë patur vështirësi për procesin mësimor për shkak të mësimit *online* si pasojë e pandemisë *Covid-19* (UNESCO, 2020). Vështirësitë për këtë kategori përfshijnë: mungesën e aksesit në mësimin *online*, cilësia e këtij shërbimi për shkak të kushteve socio-ekonomike të familjeve të tyre. Mbyllja në shtëpi ndikoi edhe si një faktor izolimi për këtë fëmijë dhe mungesës së shoqërimit me shokët e tyre, gjë e cila ndikon edhe në gjendjen dhe zhvillimin e tyre emocional. Një vështirësi tjetër në këtë kuadër ka qënë edhe mungesa e aftësive kompjuterike të mësuesve për tu dhënë mësim këtyre nxënësve. 40% e mësuesve në vendet e OCDE, kishin mungesë të aftësive kompjuterike (OECD, 2019).

Sipas një raporti të World Vision mbi impaktin e Covid-19 në mirëqënien e fëmijëve dhe familjeve të tyre në Shqipëri, sfidat më të mëdha me të cilat u ndesh kjo formë e re e mësimin ishin problemet me internetin, prindërit të cilët ishin të ndarë midis punës dhe faktit të të qenit prezent në shtëpi për të ndihmuar fëmijët e tyre në procesin mësimor, si dhe vështirësi në mësimin e lëndëve të tilla si muzika, sporti apo lëndë të tjera të lidhura me faktin e të qenit prezent fizikisht dhe jo *online*. Gjithashtu edhe fëmijët me vështirësi apo probleme patën vështirësi të madhe për të punuar individualisht dhe në mënyrë të pavarur.

Të gjithë duhet të vazhdojmë të eksplorojmë se si të krijojmë mënyra më tërheqëse dhe mjedise efektive të të mësuarit *online*. Një mënyrë për ta bërë këtë është duke integruar metoda të përshtatshme pedagogjike, për të rritur ndërveprimin dhe personalizimin e sistemit dhe për të angazhuar më shumë studentët. Kalimi nga mësimi në auditorë në atë *online* ishte diçka sfiduese në periudhën e izolimit total. Pavarësisht zhvillimit në njohuritë teknologjike, aplikimi dhe përdorimi i saj në mësimdhënie krahas avantazheve solli dhe një ndryshim të madh në mënyrën e të dhënit mësim por edhe të të mësuarit. Materialet mësimore, instalimi i softuerëve, plani i ri i mësimin ishin disa nga hapat e rëndësishmën dhe të nevojshëm për kryerjen e mësimin online.

Në Shqipëri gjate periudhës së mbylljes së shkollave nga Ministria e Arsimit dhe Agjencia e Cilësisë në arsimin parauniversitar u realizuan dy sondazhe për mësimin *online*. Raporti i parë, (MARS & ASCAP, 2020a), i zhvilluar me 321,911 fëmijë, prindër dhe mësues të arsimit publik, për klasat 1-12, pati si qëllim vlerësimin e e angazhimit të aktorëve në procesin mësimor, efektivitetin e këtj procesi. Procesi sipas sondazhit rezultoi pozitiv me një përqindje të lartë të pjesëmarrjes së mësimdhënësve dhe mësimnxënësve dhe një komunikim të vazhdueshëm midis fëmijëve, prindërve dhe mësuesve. Sipas këtij sondazhi perceptimi i prindërve dhe i mësuesve lidhur me efektivitetin e mësimin *online* është pothuajse i njëjtë me diferenca të vogla (43.6 % e prindërve dhe 37.8% e mësuesve). Po kështu edhe sondazhi i dytë (MARS & ASCAP, 2020b), i realizuar me 219,590 pjesëmarrës gjithashtu synonte të vlerësonte efektivitetin e procesit mësimor *online* si dhe produktivitetin e këtij procesi për nxënësit dhe mësuesit.

Në studimin e realizuar në pranverë të 2020, në 10 shkolla të arsimit dhe formimit profesional (AFP) pjesë e projektit “Aftësi për Punë” (S4J), të mbështetur nga Agjencia Zvicerane për Bashkëpunim dhe Zhvillim, për nxënësit dhe mësuesit realizimi i procesit mësimor nëpërmjet mësimin në distancë në situatën e krijuar nga mbyllja e shkollave dhe izolimi brenda shtëpive ka qënë një zgjidhje e kënaqshme por efektshmëria e tij lidhen me përdorimin masiv të platformave *online* që ndikohet edhe nga aftësitë digjitale në mësimdhënie dhe mësimnxënie. Mungesa e pajisjeve elektronike dhe mbështetja në internet të vazhdueshëm ndikojnë në dobësimin e cilësisë së mësimin *online*.

Në Shqipëri ka 15 institucione publike të arsimit të lartë dhe 25 institucione jo-publike me një total prej 139,043 studentësh (Viti 2018-2019), pjesa më e madhe e të cilëve janë të regjistruar në institucionet publike (113.277 studentë që përbëjnë 81% të studentëve).

Në tabelën më poshtë jepen të dhëna mbi mësimin *online* në 4 institucionet e arsimit të lartë publik më të mëdha në Shqipëri (prill 2020) lidhur me mësimin *online*.

	Institucionet e arsimit të lartë			
	Tirana	“A.M.” Durrës	Politekniku	Bujqësori
Nr. i studentëve	29.460	19.278	14.566	8.916
Platforma	Sipas vendimeve të fakulteteve Google classroom (më së shumti), me email institucionale; Microsoft teams			
Studentet që kanë ndjekur mësimin <i>online</i> (%)	90	90	86.5	80
Aktivitet mësimor	Leksione, Seminare, Ushtrime & disa Lab	Leksione & ushtrime	Leksione & ushtrime	Leksione, ushtrime & disa Lab
Duke pritur të fillojnë	Disa Lab Praktika & Diplomat	Lab Praktika & Diplomat	Lab Praktika & Diplomat	Disa Lab Praktika & Diplomat
Vështirësi të hasura nga: Stafi	Përveç javës së parë të dedikuar trajnimit disa udhëzime ishin të përgatitura nga dep e IT Kushtet e shtëpisë Sfida : nxitja e zhvillimit të mendimit kritik			
Vështirësi të hasura nga : Studentët	Internet & aksesimi në pajisjet elektronike & çështje teknike	Internet & aksesimi në pajisjet elektronike & çështje teknike	Kushtet e shtëpisë	Internet & aksesimi në pajisjet elektronike & çështje teknike
Libraria dhe materialet didaktike të downloaduara	Leksione & ushtrime pdf, ppt, etj., video të rregjistruara të leksioneve, material mbështetës, e-book, u-library etj.			

Burimi: HEREs ALBANIA 2020

Siç shikohet nga tabela platformat e përdorura nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë të kryesisht kanë qënë: *Google Classroom*, *Microsoft Teams* etj, kjo e përcaktuar me vendime të vetë institucioneve të arsimit të lartë. Frekuentimi i mësimin nga ana e studentëve ka patur një përqindje të lartë, ku të paktën 80% e tyre kanë frekuentuar mësimin *online*. Kryesisht janë zhvilluar leksione dhe ushtrime për të cilat ka qënë më e mundur mësimi *online* ndërsa disa prej laboratorëve dhe praktikave ka qënë më e vështirë. Materialet e dhëna për studentët kanë qënë: leksione & ushtrime në pdf, në ppt, etj., video të rregjistruara të leksioneve, material mbështetës, *e-book*, *u-library* etj. Vështirësia më e madhe për stafin ka qënë mësimi në kushte shtëpie ku infrastruktura nuk është ajo e duhura për zhvillimin e mësimin edhe për shkak të problemeve të aksesit në internet ndërsa për studentët kanë qënë mungesa e pajisjeve elektronike, mungesa e aksesit në internet, kushtet e shtëpisë jo të favorshme.

Mësimi *online* gjatë pandemisë është linja kryesore e edukimit por mundësitë dhe avantazhet që krijojnë teknologjitë digjitale shkojnë edhe më tej se sa thjeshtë

përdorimit si një mjet për tejkalimin e një situatë emergjente. Teknologjia digjitale ju vjen në ndihmë njerëzve se çfarë të mësojnë, ku, kur dhe si të mësojnë. Teknologjia ju mundëson mësimdhënësve dhe mësimmnxënësve të kenë akses në materiale në formate të ndryshme në çdo kohë dhe në çdo vend. Përdorimi i teknologjisë në proceset mësimore, përveç se ofron mundësi më të mëdha për një mësim më të hapur, nxjerr në pah edhe çfarë atyre ju intereson më tepër duke synuar që nxënësit të jenë më të pavarur dhe të vetëpërcaktuar, përgjegjës për të nxënit (Goode et al., 2007) dhe të fitojnë shkathtësitë vetërregulluese në raport me vendosjen e qëllimeve, të jenë vetëmonitorues dhe më të pavarur. Mësimi *online* është avantazhues për ata studentë që mund të studjojnë vetë e të ecin përpara pa u penguar nga të tjerët që mund të jenë më rezultate me të dobëta duke u krijuar mundësi edhe atyre që kanë qënë të ndrojtur nga mësimi tradicional në klasa emësimi *online* ju krijuan atyre më tepër vetbësim. (O'Donoghue, J. et al (2004)

Teknologjia jo vetëm ndryshon metodën e mësimdhënies dhe mësimmnxënies por gjithashtu përforcon rolin e mësuesit si bashkëkrijues dhe lehtësues të procesit mësimor (Huang, Liu, Tlili, Yang, Wang, et al. 2020), duke i larguar ata nga përgjegjësitë për të realizuar mësimdhënien si të vetëm, dhe gjithashtu duke u dhënë nxënësve përgjegjësi.

Analiza e të dhënave

Analiza e të dhënave të grumbulluara nga përgjigjet e studentëve


Për të marrë një pamje sa më të qartë të aplikimit të mësimit *online* në të dyja llojet e studimit në atë publik edhe në atë privat, pyetsorët u shpërndanë në Universitete të ndryshme të vendit (afërsisht 58% në universitete publike dhe afërsisht 42% në universitete private). U morën 1502 përgjigje nga studentët të universiteteve publike dhe private. Pyetsorët u shpërndanë në cikle të ndryshme studimi, 80% bachelor (viti i dytë dhe viti i tretë) dhe 20% në nivel Master (grafik 1). Për paraqitjen e rezultateve të grumbulluara nga të gjithë studentët janë përdorur forma të paraqitjes tabelare dhe grafike për ta sjellë më qartë dhe të kuptueshëm informacionin e gjeneruar nga përgjigjet e tyre.


Nga të dhënat e grumbulluara u vu re se pjesa më e madhe e studentëve ishin nga zonat urbane (rreth 78%) dhe rreth 22% e tyre nga zonat rurale (grafik 2). Gjithashtu, rezultoi se rreth 37% e studentëve banonin në bashkinë Tiranë dhe pjesa tjetër e tyre në bashki të tjera të vendit. Afërsisht 59% e tyre vinin nga familje më kryefamiljar të punësuar, 27% e studentëve deklaruan se vinin nga familje me kryefamiljar të papunë dhe rreth 3% e tyre vinin nga familje me kryefamiljar invalid (Tabela 1). Mosha mesatare e studentëve të përfshirë në zgjedhje është 20 vjeç (devijimi standard 1.24).

Tabela 1: Karakteristikat socio-demografike dhe shpërndarja gjeografike e studentëve


Karakteristikat	Numër (%)	Karakteristikat	Numër (%)
Gjinia		Universiteti	
Femër	1074 (71.5%)	Universiteti i Elbasanit	210 (14%)
Mashkull	428 (28.5%)	Universiteti i Korçës	201 (13.4%)
		Universiteti i Tiranës	262 (17.4%)
		Universiteti i Vlorës	207 (13.8%)
		Universiteti Luarasi	213 (14.2%)
Zona		Universiteti Mesdhetar	203 (13.5%)
Urbane	1170 (77.9%)	Universiteti Metropolitan	206 (13.7%)
Rurale	332 (22.1%)		
Bashkia		Statusi i punësimit të kryefamiljarit	
Bashkia Tiranë	562 (37.4%)	I punësuar	887 (59.1%)
Bashki të tjera	940 (62.6%)	I papunë	408 (27.2%)
		Invalid	38 (2.5%)
Niveli i studimit		Pensionist	40 (2.7%)
Master viti i parë	282 (18.8%)	Tjetër	129 (8.9%)
Viti i dytë bachelor	765 (50.9%)		
Viti i tretë bachelor	455 (30.3%)		

Grafik 1: Shpërndarja e pyetsorëve sipas nivelit të tyre të studimit



Grafiku 2: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas zonës së banimit

Për të zhvilluar mësimin *online* mund të përdoren pajisje të ndryshme të tilla si kompjutera *desktop*, kompjutera të lëvizshëm (*laptop*), tablet apo edhe telefonat inteligjent (*smart phone*). Pjesa më e madhe e studentëve kishin përdorur vetëm një pajisje për të ndjekur mësimin *online* dhe afërsisht 15% e tyre deklaruan se kishin përdorur për të zhvilluar mësimin *online* më shumë se një pajisje. Ndër studentët të cilët kishin përdorur pajisje të ndryshme për të ndjekur mësimin pjesa më e madhe e tyre, 85% e të anketuarve kishin përdorur dy pajisje të ndryshme. Pajisjet më shumë të përdorura nga studentët ishin *laptop*-et dhe *smart phone* 5-6 inch, përkatësisht 32% e studentëve kishin përdorur *laptop* dhe 26% e tyre kishin përdorur *smart phone* 5-6 inch. Tabletat janë përdorur më pak për të ndjekur mësimin në klasat *online*, pasi vetëm 3.2% e studentëve i kanë përdorur këto pajisje (Grafik 3). Duke qënë së në këtë pyetje ishte e mundur që të zgjidhej më shumë se një prej mundësive të paraqitura, përqindjet janë llogaritur mbi bazën e totalit të përgjigjeve të marra.

Grafik 3: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas pajisjeve të përdorura për të ndjekur mësimin *online*


Albrahim (2020) theksoi se janë gjashtë kategori të aftësive dhe kompetencave të personave që japin mësim *online*, një ndër këto aftësi është aftësia teknologjike. Në mënyrë që mësimi *online* të jetë efektiv, duhet që si pedagogët ashtu edhe studentët të kenë njohuritë e duhura jo vetëm në përdorimin e pajisjeve kompjuterike, por edhe njohuri mbi platformat e ndryshme për zhvillimin e mësimin etj.

Në pyetsor studentët u pyetën lidhur me njohuritë e tyre në teknologji, afërsisht 3% e studentëve deklaruan se kishin aftësi “Shumë të këqia” dhe vetëm 5.8% deklaruan se kishin njohuri “Të këqia”, 23% deklaruan se kishin njohuri “Të moderuara” dhe 53%


e tyre kishin njohuri “Të mira” dhe pjesa tjetër deklaruan se kishin njohuri “Shumë të mira” në teknologji (grafik 4).

Lidhur me aksesin në internet të studentëve, pyetja ishte “Nëse kishin akses në internet për leksione, seminare dhe studim të pavarur?” Rreth 24% e studentëve kishin qasje “Shumë të shpeshtë”, 29% e tyre kishin qasje të “Shpeshtë” në *internet* për leksione, seminare dhe studim të pavarur. Afërsisht 33% e studentëve deklarorin se kishin qasje “Mesatare” për leksione, seminare dhe studim të pavarur, rreth 6% “Shumë rrallë” dhe rreth 8% akses të “Rrallë” (grafik 5).

Grafik 4: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas aftësive në teknologjinë e informacionit




Grafik 5: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas aksesit në internet për leksione, seminare dhe studim të pavarur




Afërsisht 67% e studentëve kishin *WiFi*, *internet* kabllor në shtëpi, pra e siguronin internetin nëpërmjet kësaj mënyre, ndërsa pjesa tjetër e siguronin *internet*-in nëpërmjet paketave të *internet*-it nga kompanitë e telefonisë celulare. Lidhur me koston mesatare të *internet*-it u vu re se afërsisht 87.2% e studentëve deklaruan kosto të përdorimit të *internet*-it që variojnë nga 1,000 në 3,000 Lekë dhe për rreth 40% e tyre shpenzimet mesatare që ishin nga 1,500 në 2,000 Lekë (grafik 6).

Grafik 6: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas koston mesatare mujore të internetit për zhvillimin e mësimin online




Studentët u pyetën lidhur me mundësitë që ata kishin në familjet e tyre për ndjekjen e mësimit *online*. Afërsisht 48% e studentëve u shprehën se “Në pak raste” kishin një hapësirë të qetë për mësim, rreth 26% e tyre u shprehën “Po” në të paturit të një hapësire të qetë dhe rreth 22% u shprehën se “Në shumicën e rasteve” kishin një hapësirë të qetë për të zhvilluar mësimin *online* (grafik 7).

Grafik 7: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas të paturit e një hapësire të qetë për të mësuar e ndjekur mësimin *online*



Pjesa më e madhe e studentëve (76%) deklaruan se nuk punonin gjatë periudhës që mësimin e zhvillonin *online* (afërsisht 16% e tyre deklaruan se punonin para situatës së *Covid-19* por tani jo dhe 60% e tyre nuk kishin punuar më parë dhe nuk punonin edhe gjatë kësaj periudhe). Kishte studentë të cilët nuk punonin para situatës së *Covid-19* por tani punonin, rreth 14% e studentëve deklaruan se punonin tani ndonëse nuk kishin punuar para kësaj situatë dhe 10% deklaruan se punonin nga shtëpia (grafik 8).

Grafik 8: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas angazhimit në punë




Autorë të ndryshëm (Hrastinski (2008); Littlefield (2018)) kanë përkufizuar mënyrat sinkrone dhe josikrone të përdorura për mësimin *online*. Mënyra josikrone e mësimit mbështetet në përdorimin e e-maileve, forumeve në internet, regjistrime audio/video, dhe mënyrave të tjera diskutimi pa qënë e nevojshme për të qënë *online* në të njëjtën kohë. Mënyrat sinkrone të mësimit Littlefield (2018) i përcakton si mënyra e të mësuarit ku individët nuk ndodhen në të njëjtin vend, por janë në të njëjtën kohë përmes video-konferencave apo grupeve të *chat-it*, *web-seminareve* etj. Hrastinski

(2008) në punimin e tij tregoi se pavarishtësht avantazheve dhe disavantazheve të të dy këtyre mënyrave të të mësuarit ato plotësojnë njëra-tjetrën.


Pas ndërprerjes së mësimin në auditorë dhe zhvillimi i mësimin *online* solli një mënyrë të re të të punuarit, e cila u shoqërua edhe me forma të reja të mësimdhënies edhe në universitetet shqiptare. Bazuar në rezultatet e pyetsorit drejtuar studentëve, forma që ata deklaruan se përdorej më shumë gjatë leksioneve dhe seminareve *online* ishte ajo *live* përmes video-konferencave, ndjekur nga mënyra të tjera siç ishin lexim në mënyrë të pavarur i kapitullit të rekomanduar në libër, lexim në mënyrë të pavarur i prezantimit *power point*, ndjekja e video leksioneve - prezantim *power point* me audio të pedagogut që ndiqet në formë video apo ndjekja e video leksioneve - prezantim *power point* me audio e video të pedagogut që ndiqet në formë video. Më pak ishin përdorur metodat e të mësimin nëpërmjet rasteve të studimit, lektorëve të ftuar (grafik 9). (Edhe te kjo pyetje mund të zgjidheshin më shumë se një alternativë, përçindjet jepen mbi bazën e totalit të përgjigjeve të marra).

Grafik 9: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas formave të ndryshme të përdorura për të zhvilluar mësimin *online*



Lidhur me ndjekjen ose jo të njëjtës mënyrë mësimdhënie, 60% e studentëve u përgjigjën se në të gjitha lëndët ndiqej e njëjta mënyrë mësimdhënie (grafiku 10).

Nisur nga forma e përzgjedhur për zhvillimin e mësimin *online* studentët u pyetën lidhur me efektivitetin sipas tyre të secilës metode. Afërsisht një në tre studentë i vlerësojnë si mesatarisht efektive pothuajse të gjitha metodat e ndryshme të përdorura për mësimdhënie. Metodatat e leximit në mënyrë të pavarur të kapitullit të rekomanduar në libër dhe leximi në mënyrë të pavarur i prezantimit *power point*, rezultojnë në opinionin e studentëve si mënyrat më pak efektive ku, rreth 30% e studentëve i konsiderojnë si pak efektive dhe rreth 25% e tyre si aspak efektive.

Grafik 10: A ndiqej në të gjitha lëndet e njëjta mënyrë e mësimit *online*?

Afërsisht 36% e studentëve e vlerësuan mësimin *live* nëpërmjet video-konferencave si “Mesatarisht efektive”, 15% si “Shumë efektive” dhe rreth 8% si “Jashtëzakonisht shumë efektive”. Ndjekjen e video leksioneve = *power point* me audio të pedagogut që ndiqet në formë video u vlerësua si “Mesatarisht efektive” afërsisht nga 34% e studentëve dhe rreth 17% e vlerësuan si “Shumë efektive” dhe afërsisht 9% si “Jashtëzakonisht shumë efektive”. Ndjekja e video leksioneve = *power point* me audio e video të pedagogut që ndiqet në formë video e vlerësuan si “Mesatarisht efektive” 34% e studentëve dhe rreth 18% e vlerësuan si “Shumë efektive” dhe 11% si “Jashtëzakonisht shumë efektive” këtë formë të mësimdhënies. Lidhur me format e tjera të përdorura për mësimdhënie rezultojnë se përqindja e studentëve që i kanë gjykuar si “Mesatarisht efektive” varion nga 28% në 33%, shumë dhe jashtëzakonisht shumë efektive varion nga 12% në 20% të studentëve. Metodatat më pak efektive, ku një përqindje më e lartë e studentëve krahasuar me metodatat e tjera i kanë vlerësuar si aspak dhe pak efektive janë: ndjekja e materialeve video (shtesë) të propozuara, lexim i materialeve të shkruara shtesë të propozuara, lektorët e ftuar dhe përdorimi i rasteve të studimit (Tabela 2).


Tabela 2: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas efektivitetit të metodave të ndryshme të përdorura për zhvillimin e leksioneve *online*

	Shumë pak	Pak	Mesatarisht	Shumë	Jashtëzakonisht shumë	Mesatare
Lexim në mënyrë të pavarur i kapitullit të rekomanduar	25.4	31.7	30.5	7.9	4.5	2.34
Lektorë të ftuar	28.6	26	30.5	9.8	5.1	2.37
Lexim në mënyrë të pavarur i prezantimit <i>power point</i>	24.2	33.6	30	7.1	5.1	2.35
Lexim i materialeve të shkruara shtesë të propozuara	21	29.3	32.1	11.7	5.9	2.52
Raste studimi	22.6	28.1	28.6	13.4	7.3	2.55
Ndjekje e materialeve video (shtesë) të propozuara	18.6	28.5	33.5	12.7	6.7	2.6
<i>Live</i> përmes video konferencave	15.8	24.8	36.2	15	8.2	2.75
Ndjekje e video leksioneve = <i>power point</i> me audio të pedagogut që ndiqet në formë video	16.2	23.1	34.3	17.2	9.2	2.79
Ndjekje e video leksioneve = <i>power point</i> me audio e video	15.1	22.1	33.7	18.2	10.9	2.87


Siç rezultoi dhe nga përgjigjet e studentëve, për të zhvilluar mësimin *online* u përdorën metoda të ndryshme si: leksione *live* përmes video-konferencave, lexim në mënyrë të pavarur të kapitullit të rekomanduar, leximit në mënyrë të pavarur i prezantimit *power point*, ndjekje e video leksioneve - *power point* me audio të pedagogut që ndiqet në formë video, ndjekje e video leksioneve - *power point* me audio e video të pedagogut që ndiqet në formë video, ndjekje e materiale video (shtesë) të propozuara, lexim i materialeve të shkruara shtesë të propozuara, lektorë të ftuar, raste studimi dhe mënyra të tjera të përdorura.

Studentët mund të zgjidhnin midis metodave të ndryshme të përdorura për leksionet e zhvilluara *online*, katër nga metodat më të aplikuara. Sipas përgjigjeve të marra katër metodat që u përzgjedhën nga më shumë studentë ishin: Ajo e drejtpërdrejtë përmes video-konferencave, me audio te pedagogut të ndjekur me video që ndiqet në formë video, lexim i pavarur i prezantimit *power point*, lexim i pavarur i kapitullit të rekomanduar. Zhvillimi i leksioneve me lektorë të ftuar apo rasteve te studimit ishin ndër katër metodat e pak të përdorura. Edhe kjo pyetje kishte më shumë se një alternativë zgjedhje dhe përqindja është llogaritur ndaj totalit të përgjigjeve të marra (grafik 11).

Grafik 11: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas metodave më të aplikuara për mësimin *online*




Pyetjes se çfarë studentët bënin gjatë kohës kur leksionet zhvilloheshin *live*, afërsisht 36 % e studentëve deklaruan se dëgjonin dhe shikonin më vëmendje leksionin gjatë kohës së zhvillimit të tij, afërsisht 27% dekaruan se bëheshin pjesë duke ndërhyrë *live* me zë ose video dhe 17% e tyre përfshiheshin duke bërë komente të ndryshme, afërsisht 20% e studentëve deklaruan se dëgjonin leksioni, por ndërkohë shihnin edhe diçka tjetër apo ishin loguar sa për formë dhe dëgjonin herë pas here leksionin (grafik 12).

Grafik 12. Çfarë bëni kryesisht gjatë leksioneve live

Zhvillimi i mësimin *online* krahas avantazheve mund të themi se ka edhe disavantazhet apo vështirësitë e veta të lidhura kryesisht me teknologjinë dhe kostot e lidhura me të, mungesës apo kufizimit të ndërveprimit pedagog-student, vështirësisë për tu aplikuar kjo mënyrë mësimi disa degë të caktuara ku është shumë e nevojshme praktika etj.

Studentët u pyetën se se cilat ishin disa nga kufizimet/problemet që ndikojnë në opinionin e tyre për mosndjekjen 100% të mësimin *online*, studentët mund të përgjigjeshin duke zgjedhur më shumë se një alternativë. (Përqindjet e llogaritura janë mbi totalin e përgjigjeve të marra). Nga totali i përgjigjeve të marra disa nga kufizimet të cilat kanë hasur më shumë studentët janë: *Vështirësia në përqëndrim gjatë kohës që zhvillohet mësimi online* (ishte një nga kufizimet me numrin më i lartë të përgjigjeve, 824 përgjigje), *linjë e dobët interneti* (796 përgjigje), *Kosto e përdorimi të internetit* (641 përgjigje), *Orar i papërshtatshëm i zhvillimit të mësimin online* (442 përgjigje). Kanë ndikuar më pak në mosndjekjen e mësimin *online* vështirësitë në përdorimin e platformës *online*, me vetëm 157 përgjigje. Gjithashtu, kishte edhe studentë të cilët deklaruan se nuk kishin patur vështirësi për të ndjekur mësimin *online* (168 studentë) (grafik 13).

Grafik 13: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas kufizimeve që lidhen me ndjekjen 100% të mësimin online

Për të konkluduar lidhur me nivelin e vështirësive të hasura gjatë mësimin, studentët u pyetën të shprehnin opinionin e tyre (aspak, pak, mesatarisht, shumë dhe jashtëzakonisht shumë) lidhur me: Teknologjinë (kompjuterat, platforma, internet, etj), komunikimin interaktiv me lektorin, mungesës së materialeve mësimore të digjitalizuara, mungesës nga ana e tyre dhe e lektorëve injohurive digjitale, manaxhimit të kohës si dhe orientimi nga ana e fakultetit. Më shpesh është hasur përgjigjja mesatarisht për pjesën më të madhe të vështirësive të hasura gjatë mësimin *online*, përjashtuar nivelin e ulët të njohurive digjitale nga ana e vet studentëve, ku pjesa më e madhe e tyre kanë zgjedhur përgjigjen aspak, pra mungesë e pakët vështirësish nisur nga njohuritë e tyre digjitale.


Niveli i vështirësive të ardhura nga teknologjia për afërsisht 50% të studentëve ishte aspak ose pak, çka nënkupton se lidhur me teknologjinë 50% e studentëve kanë patur pak ose aspak vështirësi. Komunikimin interaktiv me lektorin për 37% të studentëve ishte pak ose aspak i vështirë, mungesa e materialeve mësimore të digjitalizuara ishte aspak ose pak i vështirë për afërsisht 42% të studentëve, studentët kanë nivel të mirë të njohurive digjitale pasi pothuajse 60% e tyre kanë patur pak apo aspak vështirësi, edhe niveli i njohurive digjitale nga ana e lektorëve rezultoi i mirë pasi një pjesë e mirë e studentëve, afërsisht 53% e studentëve deklarojnë aspak ose pak vështirësi lidhur me njohuritë e pedagogëve. Menaxhimi i kohës duket të ketë sjellë nivel pak më të lartë vështirësie krahasuar me vështirësitë e tjera pasi rreth 24% e tyre deklarojnë se kanë patur shumë ose jashtëmase shumë vështirësi, ndërkohë që: Teknologjia (kompjuterat, platforma, internet etj), komunikimi interaktiv me lektorin, mungesa e materialeve mësimore të digjitalizuara, niveli i ulët i njohurive digjitale nga ana e vet studentëve dhe pedagogëve, orientim/ mbështetje e pakët nga universiteti përqindja e studentëve që kanë deklaruar shumë dhe jashtëmase shumë vështirësi ishte nën 22% (Tabela 3).

Tabela 3: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas nivelit të nivelit të vështirësive gjatë mësimin *online*

	Shumë pak	Pak	Mesatarisht	Shumë	Jashtëmase shumë	Mesatare
Niveli i ulët i njohurive digjitale nga ana juaj	33.9	25.6	28.4	8.3	3.8	2.23
Niveli i ulët i njohurive digjitale i lektorëve	24.6	29	32.7	9.8	3.9	2.4
Teknologji (kompjuterat, platforma, internet etj)	24.4	25	28.8	14	7.8	2.55
Orientim/ mbështetje e pakët nga universiteti	19.6	23.3	35.5	13.2	8.4	2.67
Mungesa e materialeve mësimore të digjitalizuara	19.6	23.3	35.5	13.2	8.4	2.76
Komunikimi interaktiv me lektorin	12.7	24.4	39.7	15.7	7.5	2.8
Manaxhimi i kohës dhe organizimi	14.1	22.8	38.6	15.9	8.6	2.82

Lidhur me mënyrën se si i zhvillonin seminarët gjatë periudhës së mësimit *online* 29% e studentëve deklaruan se kishin zhvilluar seminarët drejtpërdrejt përmes video konferencave, afërsisht 28% e studentëve deklaruan se i zhvillonin seminarët në formën e dërgimit të detyrave të parapërgatitura me shkrim dhe 21% e tyre duke u përgjigjur pyetjeve në platforma *online*, një pjesë e vogël e studentëve rreth 9% i zhvillonin seminarët me raste studimi dhe 13% nëpërmjet mini quizeve. Nisur nga numri i përgjithshëm i përgjigjeve të marra nga studentët lidhur me mënyrën e zhvillimit të seminarëve, përqindja e përgjigjeve për secilën mënyrë jepen në grafikun 14.

Grafik 14: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas mënyrës së zhvillimit të seminarëve gjatë mësimit *online*



Mësimi *online* ishte një alternativë e cila solli zhvillimin e mësimit dhe transmetimin e njohurive edhe në kushtet e pamundësisë së zhvillimit të tij në auditore. Studentët vlerësuan në gjykimin e tyre se sa relevante ishte secila nga deklaratat lidhur me aspekte të ndryshme të mësimit *online* si: marrja e njohurive për lëndën, nxitjes së reflektimit mbi aspektet që studentët mësojnë, ndërveprimin me pedagogun, nxitjes të menduarit në mënyrë kritike, nxitjes së kreativitetit, shprehjes së lirshme të opinioneve të tyre, kohës së shpenzuar për të mësuar, volumi i mësimit, zgjedhjes së kohës për përmbushjen e detyrimeve për seminarët etj. Përgjigjet për deklaratën se gjatë mësimit *online* studentët mësonin njohuri vetëm për lëndën, afërsisht 44% e tyre mendonin se kjo deklaratë ishte mesatarisht relevante, rreth 25% pak relevante, 10% aspak relevante, 14% shumë relevante dhe pjesa tjetër jashtëzakonisht shumë relevante.

Nxitja e reflektimit mbi aspektet që studentët mësonin gjatë mësimit *online*, si dhe nxitja e kreativitetit duket të jenë vlerësuar njëllë nga studentët ku pjesa më e madhe e tyre (përkatesisht 34% dhe 32% e studentëve) janë shprehur “Mesatarisht relevante”, afërsisht 29% e studentëve për të dyja këto deklarata janë shprehur si “Pak relevante” dhe rreth 20% e tyre si “Aspak relevante”. Ndryshe nga deklaratat lidhur me nxitjen e punës në grup dhe përdorimit të këtyre praktikave edhe kur të kthehen në universitet, ku më shpesh studentët i kanë konsideruar si “Aspak relevante” (përkatesisht 31% dhe 30% e studentëve), përgjigjet për pjesën më të madhe të deklaratave studentët japin vlerësimin “Mesatarisht relevante”. Nga ana tjetër, përdorimit të këtyre praktikave edhe kur të kthehen në universitet si dhe vështirësitë e tyre për tu vetëorganizuar për të mësuar, janë deklaratat ku, vlerësimi “Jashtëzakonisht shumë” kundrejt të gjitha


deklaratave të tjera është në përqindje më i lartë (përkatësisht afërsisht 12% dhe 11%) (Tabela 4).

Tabela 4: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas opinionit për deklarata lidhur me mësimin *online*

	Aspak	Pak	Mesatrisht	Shumë	Jashtëzakonisht Shumë	Mesatare
Mësoj vetëm njohuri për lëndën	10	24.8	43.6	14.1	7.5	2.84
Më nxit të reflektoj mbi aspektet që mësoj	19	30.6	34.1	10.4	5.9	2.54
Nxit të menduarit në mënyre kritike	20.8	29.5	32.4	11.4	5.9	2.52
Nxit kreativitetin	24.9	28.9	29.4	9.5	7.3	2.45
Nxit punën në grup	30.7	26.6	27.1	10.2	5.4	2.33
Ndërveprimi me pedagogun është i lartë	21.2	28.6	33.7	10.1	6.4	2.52
Mund të shpreh lirshëm opinionet e mia	18.2	28.1	30.7	14.2	8.8	2.67
Shpenzoj më pak se 2 orë për të mësuar	30.2	23.8	31.3	9.3	5.5	2.36
Platformat e mësimin <i>online</i> ndihmojnë në organizimin e materialeve, detyrave e orarit	25.6	28.4	28.7	10.6	6.7	2.45
E kam të vështirë të vetëorganizohem për të mësuar	19	28.8	28.6	12.8	10.8	2.68
E zgjedh vetë kur të përmbush detyrimet e seminarit	25.2	28.2	30.1	10.1	6.4	2.44
Volumi është i përballueshëm	22.5	24.6	31.6	13.4	7.9	2.6
Disa nga këto praktika do doja të vijojnë edhe kur të kthehem në universitet	30.2	23.6	24.6	10.1	11.5	2.49


Përsa i përket efektivitetit të mësimin *online* krahasuar me mësimin e zhvilluar në fakultet më shpesh është hasur përgjigja “Aspak efektiv” me afërsisht 34% e studentëve, rreth 29% e studentëve mendojnë se mësimi *online* është “Pak efektiv” dhe po kjo përqindje studentësh mendojnë se mësimi *online* është “Mesatarisht efektiv” krahasuar me mësimin në auditore, vetëm 8% e tyre mendojnë se mësimi *online* është “Shumë efektiv” apo “Jashtëzakonisht shumë efektiv” (Grafik15).

Grafik 15: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas efektivitetit të mësimit *online* në raport me mësimin tradicional të zhvilluar në fakultet




Studentët u pyetën se çfarë do të donin të ndryshonte në mësimin *online* lidhur me: infrastrukturën fizike, materialet digjitale, kapacitetet e studentëve dhe kapacitetet e pedagogëve, pjesa më e madhe e studentëve mendojnë se duhen bërë ndryshime në infrastrukturën fizike, materialet digjitale dhe kapacitetet e studentëve dhe jo në kapacitetet e pedagogëve (Grafik 16).

Grafik 16: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas opinionit se çfarë do të donin të ndryshonte në mësimin *online*




Pyetjes nëse studentët ishin të kënaqur me ndërthurjen e seminareve me leksionet, afërsisht 37% e studentëve ishin “Mesatarisht të kënaqur” dhe afërsisht 23% e tyre ishin “Shumë pak të kënaqur”, rreth 26% “Pak të kënaqur”, pjesa tjetër e studentëve ishin “Të kënaqur” dhe “Shumë të kënaqur” (Grafik 17).


Grafik 17: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas kënaqësisë nga ndërthurja e seminareve me leksionet gjatë mësimit *online*




Lidhur me nxitjen e studentëve nga pedagogu në diskutim dhe mendim kritik, përmbajtjen e tezave në provime në përputhje me mësimin *online* dhe krijimin nga pedagogët e një klimë të përshtatshme e mbështetëse për studentët në zhvillimin e ideve të reja, më shpesh u has përgjigja “Mesatarisht të kënaqur”, kjo përqindje varioje nga 37% në 40% të përgjigjeve të studentëve, ku afërsisht 15% ishin “Shumë pak të kënaqur” me nxitjen që pedagogu dhe rreth 20% ishin “Pak të kënaqur”, rreth 16% “Shumë të kënaqur” dhe rreth 8% ishin “Plotësisht të kënaqur” lidhur diskutimin dhe mendimin kritik. 13% e studentëve ishin “Shumë pak të kënaqur”, 15% “Pak të kënaqur”, 18% ishin “Shumë të kënaqur” dhe 16% ishin “Plotësisht të kënaqur” me përmbajtjen e tezave të provimit në përputhje me mësimin *online*. Rreth 14% ishin “Shumë pak të kënaqur”, 17% “Pak të kënaqur”, po afërsisht e njëjta përqindje (17%) ishin “Shumë të kënaqur”, 12% ishin “Plotësisht të kënaqur” me klimën që pedagogët krijuan për mbështetjen e studentëve në zhvillimin e ideve të reja (grafikët 18, 19, 20). **Grafik 18: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas nxitjes nga pedagogu i diskutimit dhe mendimit kritik gjatë mësimin *online***



Grafik 19: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas përputhjes që përmbajtja e tezave në provime kishte me mësimin *online*



Grafik 20: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas krijimit nga pedagogët e një klimë të përshtatshme dhe mbështetëse për studentët në zhvillimin e ideve të reja



Disa nga avantazhet e zhvillimit të mësimin *online* janë mundësia e aksesimit të materialeve në çdo kohë, mundësia e të ndenjturit në shtëpi pa qënë e nevojshme të dalësh, komforti që krijohet, mundësia për të regjistruar një mësim etj. Krahas avantazheve, mësimi *online* ka edhe disavantazhet e veta, kryesisht të lidhura problemet teknike, uljen e komunikimit student-pedagog, izolimi social etj. Kryesisht, për secilin nga këto avantazhe: mundësia e aksesimit të materialeve në çdo kohë, mundësinë e të ndenjturit në shtëpi pa qënë e nevojshme të dalësh, komforti dhe mundësia për të regjistruar një mësim më shpesh u vu re vlerësimi “Mesatarisht” i cili varionte afërsisht nga 29% në 36%. Lidhur me mundësinë e aksesimit të materialeve në çdo kohë 14% e vlerësuan “Plotësisht”, 17% “Shumë”, rreth 19 % pak dhe rreth 16% “Aspak” këtë avantazh. Lidhur me mundësinë e të ndenjturit në shtëpi afërsisht 16% e studentëve e vlerësuan si “Plotësisht”, rreth 23% “Shumë”, 29% “Pak” dhe rreth 17% “Aspak” këtë avantazh të mësimin *online*. Interaktiviteti në klasë në ndryshim nga avantazhet e tjera një pjesë e madhe e studentëve e vlerësuan “Shumë pak” dhe “Pak” (përkatesisht 27% dhe 25% e studentëve), vetëm 7% e tyre e vlerësuan “Shumë” dhe afërsisht 6% e studentëve e vlerësuan “Plotësisht”. Mundësinë për të regjistruar një mësim e vlerësuan si “Plotësisht” 14% e studentëve, “Shumë” dhe “Pak” e vlerësuan përkatesisht 20% e studentëve dhe “Aspak” 15% e tyre. Komforti i krijuar përreth gjatë mësimin *online* u vlerësua si “Plotësisht” nga 13%, “Shumë” nga afërsisht 15%, 21% u shprehën “Pak” dhe “Aspak” u shprehën rreth 18% e studentëve (Tabela 5).

Tabela 5: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas vlerësimit të avantazheve të mësimin *online*

	Shumë pak	Pak	Mesatarisht	Shumë	Plotësisht	Mesatare
Mundësi aksesimi i materialeve në çdo kohë	6.5	18.5	34.1	17	13.8	2.93
Mundësia e të ndenjturit në shtëpi	15.0	16.8	29.1	23.2	15.9	3.1
Interaktiviteti në klasë	26.9	24.6	35.8	6.9	5.5	2.4
Mundësinë për të regjistruar një mësim	15.4	19.7	31.2	19.8	13.9	2.97
Komforti përreth	18.2	20.5	33.5	14.6	13.2	2.84

Tabela 6: Shpërndarja e studentëve të intervistuar sipas vlerësimit të disavantazheve të mësimin *online*

	Shumë pak	Pak	Mesatarisht	Shumë	Plotësisht	Mesatare
Zvogëlon komunikimin me pedagogun	10.2	18.2	26.4	25	20.2	3.27
Problemet teknike	7.4	13.4	26.8	30.2	22.2	3.47
Kushte jo të mira studimi në shtëpi	16.3	18.4	30.9	17.8	16.6	2.99
Izolimi social	8.6	13.7	25.4	22.5	29.8	3.51
Mungesa e një disipline vetjake	15.0	19.7	30.9	18.2	16.2	3.01

Lidhur me disavantazhet e zhvillimit të mësimin *online*, vihet re që në përgjigjet e studentëve kanë vlerësuar problemet teknike dhe izolimin social si disavantazhet ku


për problemet teknike rreth 30% e studentëve e kanë vlerësuar shumë dhe izolimin social ku po e njëjta përqindje studentësh e kanë vlerësuar plotësisht këtë disavantazh të mësimin *online*. Zvogëlimi i komunikimit me pedagogun në përqindje të lartë studentët janë shprehur shumë dhe plotësisht, përkatësisht 25% dhe 20% e studentëve. Mungesa e disiplinës vetjake si dhe kushtet jo të mira në shtëpi, kanë një shpërndarje të njëjtë të përqindjes së atyre studentëve që janë shprehur shumë pak/ pak kundrejt atyre që janë shprehur shumë/ plotësisht (Grafik 25).

Analiza e të dhënave të grumbulluara nga përgjigjet e pedagogëve

Me qëllim që problemet, sfidat dhe arritjet gjatë mësimin *online* të shiheshin edhe nën këndvështrimin e pedagogëve, ashtu siç u theksua edhe tek metodologjia e kërkimit, u ndërtua pyetësori dhe u mblodhën mendime edhe nga pedagogët.



Pyesori u shpërnda *online* te 245 pedagogë (35 për secilin fakultet) bazuar në një zgjedhje të rastit dhe përgjigjje u morën nga 233 pedagogë me një normë mesatare refuzimi 4.9% (norma e refuzimit varion midis universiteteve nga 0.0% deri në 11.4%).

Grafik 21: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas IAL-ve



Grafiku në vijim jep strukturën e pedagogëve të intervistuar sipas gjinisë, ku vihet re se predominojnë pedagogët femra me 68.2% dhe mendojmë se kjo është një strukturë e përafërt me strukturën e pedagogëve në universitete dhe ka lidhje edhe faktin se në këtë strukturë mbizotërojnë femrat.


Të dhënat e grafikut në vijim paraqesin strukturën moshore të të intervistuarve. Vihet re se më shumë se gjysma e tyre janë në moshën 31-50 vjeç dhe vetëm 3.9% janë të moshës mbi 60 vjeç. Mendojmë se kjo strukturë është përfaqësuese e strukturës moshore të pedagogëve në IAL publike dhe private në Shqipëri.

Grafik 22: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas gjinisë**Grafik 23: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas moshës**

Një ndër pyetjet në vijim ishte “Ku e keni zhvilluar mësimin *online*?”. Përgjigjet e marra janë paraqitur në grafikun në vijim. Nga të dhënat vihet re se të ndikuar nga kushtet e pandemisë pjesa më e madhe e mësimin *online* është zhvilluar në banesat e pedagogëve (86.7%) dhe në 9% të rasteve mësimi është zhvilluar në zyrë, ndërsa vetëm në 4.3% të rasteve është zhvilluar në auditor. Zhvillimi i mësimin *online* në kushte shtëpie mendojmë se nga njëra anë përdor komfortin e të qenit në banesë por nga ana tjetër mendojmë se kushtet e mësimdhënies shpesh mund të kenë probleme dytësore në raport me zhvillimin e mësimin në mjedise pune.


Grafik 24: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas vendit të zhvillimit të mësimin

Në vijim pedagogët u pyetën lidhur me “Sa orë në javë keni dhënë mësim *online*?”. Nga përgjigjet e marra vihet re një shpërndarje e gjerë e orëve javore të mësimin *online*, por më shumë janë përgjigjet për 7-8 orë. Niveli mesatar i orëve të mësimin të dhëna nga një pedagog është 7.7 orë në javë që është një ngarkesë normale mesimorë (rreth 230 orë mësimin në një vit akademik).

Grafik 25: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas numrit të orëve javore


Përgjigjet e marra për pyetjen “A keni eksperiencë të mëparshme të mësimit *online*?” tregojnë se gjysma e pedagogëve nuk kanë patur eksperiencë të mëparshme të mësimit *online* dhe vetëm 9% e tyre (6.9%+2.1%) kanë qenë të familjarizuar me këtë formë mësimdhënie.

Grafik 26: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas eksperiencës për mësim *online*




Analiza e përgjigjeve të marra për pyetjen ”Për sa lëndë ju është dashur të adoptoni me metodat *online*?” për mendimin tonë paraqet 2 probleme. Së pari, vështirësitë e përballuara nga pedagogët që në një periudhë të shkurtër ju duhej të përgatisnin për mësimin *online* disa lëndë (mesatarja rezulton 2.8 lëndë) dhe së dyti, duhet të kemi parasysh se kemi të bëjmë me shkelje të legjislacionit në fuqi, ku një pedagog nuk mund të jap mbi 3 lëndë gjatë një viti akademik. Pra, duke supozuar që të gjithë pedagogët nuk kanë dhënë lëndë të tjera në semestrin e parë, gjë që ka pak gjasa të jetë e vërtetë, atëherë si statistikë deskriptive rezulton se të paktën 24% e pedagogëve janë në shkelje të ligjit (pedagogët që kanë deklaruar 4 dhe mbi 4 lëndë në semestrin e dytë të vitit akademik 2019-2020).

Grafik 27: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas numrit të lëndëve *online*




Një vlerësim logjikisht i pritshëm më pozitiv është marrë lidhur me pyetjen “Para situatës *Covid-19* kur mësimi bëhej në auditore, si do t’i vlerësonit njohuritë tuaja të mëparshme lidhur me mësimin *online*?”. E themi këtë sepse është në prirjen njerëzore që gjithmonë shkallën e njohurive ta paraqesin disi më lartë se realiteti. Megjithatë, përgjigjet e marra korrelojnë me pyetjen e mëparshme jo vetëm sepse 41.6% deklarojnë se nuk kanë patur njohuri ose kanë patur shumë pak njohuri, por edhe sepse vetëm 20.2% deklarojnë se njohuritë e tyre kanë qenë shumë të mira.

Grafik 28: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas njohurive të mëparshme për mësimin online




Situata e sforcuar e bërjes së mësimin *online* ka rritur shkallën e të njohurive të pedagogëve për metodën e mësimin *online*. Kjo gjë vihet re nga përgjigjet e marra lidhur me pyetjen “Në terma numerike, duke nisur nga niveli juaj fillestar, sa mendoni se janë rritur njohuritë tuaja për mësimin *online*?”, ku njohuritë janë rritur mbi 50% për 63.5% të pedagogëve të intervistuar. Po të kemi parasysh këtu edhe grupin e pedagogëve që në pyetjen e mëparshme kanë deklaruar se kishin njohuri të mira (prej tyre pritej rritje e ulët e njohurive) atëherë mund të theksojmë se eksperiencia e fituar është një bazë shumë e mirë për të zhvilluar në mënyrë më cilësore mësimin *online* që po zhvillohet aktualisht.

Grafik 29: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas rritjes së njohurive për mësimin online




Në vrojtimin e bërë informacioni lidhur me udhëzimet e dhëna nga universitetet lidhur me metodën e mësimin *online* u kërkua përmes pyetjes “Pas konfirmimit të mbylljes së mësimin në auditore, a keni marrë nga universiteti udhëzimet e nevojshme për të kryer mësimin *online*?”. Përgjigjet e marra tregojnë se universitetet kanë punuar relativisht mirë në dhënien e informacionit lidhur me platformat e mësimin *online* pasi niveli mesatar del rezultat 3.2. Pra, vlerësimi i bërë është pak mbi nivelin mesatar (i koduar me numrin 3). Por duhet të theksojmë se 27.1% e përgjigjeve theksojnë se informacioni ka qenë i pamjaftueshëm dhe po të shtojmë këtu edhe 3.9% që theksojnë se nuk kanë marrë asnjë informacion atëherë niveli arrin në 31%.

Grafik 30: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas udhëzimeve për mësimin online




Në vijim u kërkua informacion lidhur me faktin se “Sa e vështirë ka qenë për ju të kuptuarit e udhëzimeve të ofruara?”. Nga përgjigjet e marra vihet re se niveli i vështirësisë vlerësohet në 2.5 (midis e lehtë dhe mesatare). Rreth 40% e të intervistuarve deklarojnë vështirësi mesatare, por vetëm 12% deklarojnë vështirësi të mëdha dhe shumë të mëdha. Pra, nuk ka qenë shumë e vështirë për pedagogët që të ambientohen me mësimin *online* dhe me platformat e përdorura.

Grafik 31: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas kuptueshmërisë së udhëzimeve



Në linjën e këtyre pyetjeve ishte edhe pyetja “Sa e vështirë ka qenë për ju organizimi i lëndës *online*?”. Nga përgjigjet e marra vihet re se përsëri shumica e pedagogëve deklarojnë vështirësi mesatare (56.7%) dhe vetëm 21.7% e tyre kanë deklaruar vështirësi të mëdha dhe shumë të mëdha. Niveli mesatar i të gjithë përgjigjeve të marra jep vlerën prej 3.0 (pra vështirësi mesatare).

Grafik 32: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas vështirësisë të organizimit të mësimin *online*



Një bllok më vete pyetjesh kanë lidhje me mënyrën e fitimit të njohurive dhe mënyrën e konceptimit të mësimin *online*. Kështu nga përgjigjet e pyetjes “Si i keni fituar njohuritë tuaja të nevojshme të mësimin *online*?” (lejohej të përzgjidhej më shumë se një alternativë, prandaj numri i përgjigjeve nuk është 233), vihet re se puna në mënyrë autodidakte ka qenë alternativa kryesore e zgjedhur. Pra me gjithë trainimet dhe njohuritë e marra përsëri aplikimi në orët e mësimin dhe adaptimi në mënyrë autodidakte me çdo situatë të krijuar ka qenë burimi kryesor i njohurive, e ndjekur nga zgjedhja e alternativës “Falë kolegëve të mi, ekspertëve dhe tutorialeve”. Pra, puna e pavarur ka qenë burimi kryesor i njohurive.

Tabela 7: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas mënyrave të fitimit të njohurive

Nr	Mënyra e fitimit të njohurive	Nr	Në %
1	Autodidakt	146	41.6
2	Falë kolegëve të mi, ekspertëve dhe tutorialeve	115	32.8
3	Nëpërmjet kurseve dhe trajnimeve të ofruara nga universiteti ku unë punoj	65	18.5
4	Nëpërmjet kurseve dhe trajnimeve të ofruara nga një universitet apo institucion tjetër	25	7.1
Gjithsej		351	100.0

Duke kërkuar arsyet pse u përdor një platformë ose një tjetër ne ndërtuam pyetjen “Cila është arsyeja kryesore e përzgjedhjes së metodës tuaj?”. Pas përpunimit të përgjigjeve të marra vihet re se gjysma e pedagogëve deklarojnë se kanë përdorur platformën e sygjeluar nga universiteti. Ndërsa gjysma tjetër e pedagogëve deklarojnë arsye të ndryshme të cilat paraqiten në tabelën në vijim.

Tabela 8: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas arsyes së përzgjedhjes së metodës së mësimin *online*

Nr	Arsye e përzgjedhjes	Nr	Në %
1	Është më e lehta për tu përdorur nga studentët	63	27.0
2	Është më e përdorura	31	13.3
3	Kjo është metoda që njoh më mirë	25	10.7
4	Këtë metodë ka vendosur fakulteti të përdor	114	48.9
Gjithsej		233	100.0

Pyetja “A ndiheni të përgatitur për të punuar me klasat tuaja *online*?” u ndërtua me qëllim që të merrej informacion mbi faktin se sa eksperiencia e fituar i ka aftësuar pedagogët për të vazhduar mësimin *online*. Nga përgjigjet e marra vihet re se vetëm 15.5% e të intervistuarve kanë deklaruar se nuk ndihen të përgatitur, gjë që tregon se eksperiencia e fituar është një bazë e mirë për ta zhvilluar mësimin *online* në mënyrë më cilësore në periudhën në vazhdim.

Tabela 9: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas përgatitjes për mësim *online*

Nr	A ndiheni të përgatitur	Nr	Në %
1	Nuk ndihem i përgatitur	13	5.6
2	Pak ose shumë pak i përgatitur	23	9.9
3	Mjaftueshëm i përgatitur	115	49.4
4	Shumë i përgatitur	70	30.0
5	Jashtëzakonisht shumë i përgatitur	12	5.2
Gjithsej		233	100.0

Nevoja e madhe për të bërë digjitalizimin vihet re edhe nga përgjigjet e pyetjes “Sa i rëndësishëm mendoni se është digjitalizimi në klasë për të dhënë mësim në universitet?”. Pjesa më e madhe e të anketuarve, me 77.2% të përgjigjeve, janë në favor të rritjes së nivelit të digjitalizimit sepse e deklarojnë atë si një komponent të rëndësishëm ose shumë të rëndësishëm, ndërkohë që vetëm 4.3% deklarojnë se ka pak ose aspak rëndësi procesi i dixhitalizimit.

Tabela 10: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas rëndësisë së digjitalizimit

Nr	Dixhitalizimi	Nr	Në %
1	Nuk ka rëndësi	3	1.3
2	Pak ose shumë pak rëndësi	7	3.0
3	Disi i rëndësishëm	43	18.5
4	I rëndësishëm	97	41.6
5	Shumë i rëndësishëm	83	35.6
Gjithsej		233	100.0

Përgjigjet e pyetjes “Me cilën metodë mësimi jeni më komod?” në mënyrë të natyrshme janë në favor të metodës së zhvillimit të mësimit në auditor (ballë për ballë me studentët) si metoda më e mirë (60.5%). Gjithsesi, jo të paktë janë ata që pëlqejnë edhe alternimin /gërshetimin e të dy metodave (27.5%) gjë që tregon se universitetet duhet të marrin masa që me kalimin e kohës edhe alternativa e mësimit *online* duhet të vazhdojë të jetë prezente në mësidhënie në nivele të ndryshme dhe për arsye të ndryshme.

Tabela 11: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas metodës së mësimdhënies ku ndihen më komod

Nr	Ku ndiheni më komod	Nr	Në %
1	Me mësimin në auditor	141	60.5
2	Me mësimin <i>online</i>	5	2.1
3	Ndihem komod me alternimin e mësimit në auditor me atë <i>online</i>	64	27.5
4	Nuk ka rëndësi për mua	23	9.9
Gjithsej		233	100.0

Përgjigjet e pyetjes “Në përgjithësi, si do ta vlerësonit eksperiencën e adaptimit të mësimit në auditor me atë *online*?” tregojnë se adoptimi i mësimdhënies së kombinuar si në auditor dhe *online* është një metodë e pëlqyer nga shumë pedagogë (43.3%), por shumë prej tyre (42.1%) janë përgjigjur se janë neutral dhe kjo përgjigje është disi e vështirë për tu interpretuar. Por me pozitivitet ajo mund të interpretohet si një eksperiencë e cila edhe mund të përdoret në të ardhmen.

Tabela 12: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas eksperiencës prej mësimit *online*

Nr	Eksperienca	Nr	Në %
1	Negative	34	14.6
2	As pozitive dhe as negative	98	42.1
3	Pozitive	90	38.6
4	Shumë pozitive	11	4.7
Gjithsej		233	100.0

Me mjaft interes në pyetsor është informacioni i marrë nga përgjigjet e bllokut të pyetjeve të paraqitura në tabelën në vijim. Të nëntë pyetjet janë renditur në bazë të nivelit mesatar të përgjigjeve të marra duke koduar alternativat sipas shkallës *likert* (1=aspak dakord, 2=pak dakord, 3=mesatarisht, 4=dakord dhe 5=plotësisht dakord). Nga përgjigjet e marra vihet re se transferimi i mësimit nga auditori në *online* nuk ishte një proces i lehtë sepse përgjigjet tentojnë të jenë drejt nivelit “pak dakord” të ndjekura nga niveli i përgjigjeve për fleksibilitetin e mësimit *online* krahasuar me atë tradicional, ku përgjigjet janë gati në të njëtin nivel (midis “pak dakord” dhe “mesatarisht”) dhe po në këtë fashë përzgjedhjesh janë edhe përgjigjet e marra për përfshirjen aktivisht të studentëve në mësimin *online*. Nga ana tjetër pedagogët e kanë vlerësuar “mesatarisht” mundësinë që të kontrollojnë studentët gjatë mësimit *online* dhe kontrollin që mund të bëjnë për performancën e studentëve gjatë mësimit *online* dhe gati po në të njëtin nivel vlerësohet edhe qenia aktiv e studentëve gjatë orës së mësimit *online*. Vlerësim më pozitiv (në fashën drejt qenies dakord) japin përgjigjet e pyetjeve lidhur me besueshmërinë e teknologjisë që është përdorur për mësimin *online* si dhe lidhur me mjetet e komunikimit gjatë mësimit *online*. Natyrisht që pedagogëve

ju ka munguar kontakti i drejtpërdrejtë me studentët (difekt i mësimit *online*) ku vetëm 9.4% e tyre janë përgjigjur se nuk e kanë patur problem kontaktin e drejtpërdrejtë me studentët.

Tabela 13: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas opinionit për disa çështje

Nr	Deklarimi	Aspak dakord	Pak dakord	Mesatarisht	Dakord	Plotësisht dakord	Mesatarja
1	Transferimi i plotë i mësimit i gjithi <i>online</i> ishte i qetë	25.3	21.9	33	14.6	5.2	2.5
2	Fleksibiliteti ofruar nga mësimi <i>online</i> është më i madh se ai tradicional	21.9	32.2	19.7	20.6	5.6	2.6
3	Studentët e mi <i>online</i> janë të përfshirë aktivisht	9.9	24.9	43.7	17.2	4.3	2.8
4	Nuk kam asnjë problem të kontrolloj studentët e mi gjatë mësimit <i>online</i>	8.6	26.6	30.5	26.6	7.7	3.0
5	Jam në gjendje të siguroj një reagim më të mirë të studentëve të mi lidhur me performancën e tyre gjatë mësimit <i>online</i>	7.3	22.7	38.7	22.7	8.6	3.0
6	Studentët e mi janë shumë aktivë në komunikimin me mua lidhur me temat e lëndës	5.6	21.5	40.7	27	5.2	3.1
7	Teknologjia që unë përdor gjatë mësimit <i>online</i> është e besueshme	6.9	14.6	27.9	37.3	13.3	3.4
8	Jam i kënaqur me mjetet e komunikimit të përdorura gjatë mësimit <i>online</i> (psh class rooms etj)	4.3	13.3	30.9	36.5	15	3.5
9	Më mungon kontakti i drejtpërdrejtë i mësimit tradicional	3	6.4	25.8	24	40.8	3.9

Nga matja e bërë përmes pyetjes “Çfarë ju ka surprizuar më shumë gjatë mësimit *online*?” vihet re se përgjigjet e marra tregojnë një gamë të gjerë opsionesh, ku më shumë pedagogët janë surprizuar nga inovacioni dhe mundësia për tu përshtatur dhe më tej vijnë përgjigjet lidhur me aksesueshmërinë, autonominë dhe fleksibilitetin dhe mjetet e shumta që mund të përdoren edhe gjatë mësimit *online*. Natyrshëm që në fund do të renditeshin lehtësia e përdorimit dhe dobia e mësimit *online* sepse është e kuptueshme që këto janë edhe çështjet më problematike të mësimit *online*.

Tabela 14: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas përgjigjeve për pyetjen “Çfarë ju ka surprizuar më shumë gjatë mësimit *online*?”

Nr	Çfarë ju ka surprizuar	Nr	Në %
1	Fleksibiliteti	29	12.4
2	Mjetet e shumta që mund të përdoren	27	11.6
3	Aksesueshmëria (platforma, materialet, burimet)	31	13.3
4	Inovacioni (psh liria për të eksperimentuar me praktikën e mësimit)	45	19.3
5	Përshtatja (aftësia për të personalizuar të mësuarit për studentët)	43	18.5
6	Autonomi, motivim, vetë-rregullim midis studentëve	29	12.4
7	Lehtësia në përdorim	15	6.4
8	Dobia	14	6.0
Gjithsej		233	100.0


Pyetjes “A mendoni se do të përdorni mësimin *online* edhe pas rikthimit në auditore?” i janë përgjigjur pozitivisht gati 2/3 e pedagogëve të intervistuar, duke treguar në këtë mënyrë se kjo ishte një eksperiencë me vlerë dhe që do të përdoret edhe si metodë mësimit alternative edhe në kushtet normale të mësimit. Pra, pedagogët kanë patur se çfarë të mësojnë nga eksperiencia e mësimit *online* dhe nga kombinimi me metodën tradicionale të mësimit në auditore.

Tabela 15: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas përdorimit në vazhdim të mësimit *online*

Nr	Do ta përdorni	Nr	Në %
1	Po	146	62.7
2	Jo	87	37.3
Gjithsej		233	100.0

Përgjigjet e pyetjes “Sa e vështirë ka qenë për ju organizimi i lëndës *online*?” tregojnë se shumica e pedagogëve të intervistuar kanë hasur vështirësi mesatare dhe ka një përqindje gati të barabartë si për ata që shprehen se vështirësitë kanë qenë të mëdha dhe shumë të mëdha 21.5% dhe për ata që ka qenë e lehtë dhe shumë e lehtë 21.9%. Mesatarja e të dhënave rezulton 3, pra në nivelin e vështirësive mesatare.

Grafik 33: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas vështirësisë së organizimit të mësimit *online*



Të pyetur “Cilat mendoni ka qënë arsyeja/arsyet që kanë sjellë vështirësi?” të intervistuarit i kanë renditur vështirësitë duke filluar nga mungesa e kohës (mësimi *online* filloi menjëherë pa kohë përgatitore), mungesa e mjeteve dhe burimeve teknologjike, mungesa e njohurive, duke vazhduar me vështirësi të tjera në nivele jo të konsiderueshme.

Tabela 16: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas arsyeve të vështirësive

Nr	Arsyeja kryesore e vështirësisë	Nr	Në %
1	Mungesa në mjete dhe burime teknologjike (kompjuter ose internet)	81	22.9
2	Mungesa e kohës për të organizuar metodologjinë <i>online</i>	117	33.1
3	Mungesa e njohurive në metodologjinë <i>online</i>	79	22.4
4	Mungesa e udhëzimeve të sakta rreth asaj që duhej bërë, udhëzime konfuze	30	8.5
5	Udhëzime konfuze	30	8.5
6	Vështirësi (nga ana ime) të të kuptuarit të udhëzimeve nga universiteti	16	4.5
Gjithsej		233	100.0

Të pyetur rreth platformave të përdorura (“Çfarë platforme përdoret për të zhvilluar mësimin *online*?”), mund të zgjidhni më shumë se një alternativë), vihet re se platforma

më e përdorur ka qenë *Google Classroom*. Në tabelën në vijim i kemi renditur platformat sipas nivelit të përdorimit nga pedagogët.

Tabela 17: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas platformave të përdorura

Nr	Platforma	Nr	Në %
1	Google Classroom	182	31.4
2	Zoom	88	15.2
3	E-mail	82	14.2
4	WhatsApp	55	9.5
5	Go to Meeting	54	9.3
6	Microsoft teams	44	7.6
7	PPT recording	33	5.7
8	Moodles	22	3.8
9	Skype	10	1.7
10	Onedrive	9	1.6
Gjithsej		579	100.0

Me mjaft interes është analiza e përgjigjeve lidhur me pyetjen “Me çfarë pajsje e keni zhvilluar mësimin *online*?”. Vihet re se mbizotëron përdorimi i laptopit (57.8%) i ndjekur nga përdorimi i celularëve (21.0%) dhe më tej kompjuteri (18.4%) dhe tableti (2.9%). Mendojmë se paraqet interes të gjykohet sa sa e lehtë është kryerja e mësimi përmes celularit!

Tabela 18: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas paisjeve të përdorura

Nr	Paisja	Nr	Në %
1	Kompjuter	58	18.4
2	Laptop	182	57.8
3	Telefon celular	66	21.0
4	Tablet	9	2.9
Gjithsej		315	100.0

Të intervistuarit u pyetën edhe lidhur me faktin se “Çfarë mund të përmirësohet për realizimin e mësimi *online*?”. Nga përgjigjet e marra vihet re se theksi vendoset mbi përmirësimin e materialeve dixhitale dhe infrastruktures fizike, por gjithashtu theksohen edhe se studentët dhe pedagogët duhet të bëjnë më shumë përpjekje për përmirësimin e punës.

Tabela 19: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas mendimeve për përmirësimet

Nr	Çfarë mund të përmirësohet	Nr	Në %
1	Materialet digjitale	171	38.3
2	Kapacitetet e studentëve	95	21.3
3	Infrastruktura fizike	113	25.3
4	Kapacitetet e lektorëve	68	15.2
Gjithsej		447	100.0

Së fundi, të intervistuarit u pyetën edhe lidhur me faktin se “Në opinionin tuaj cilat kanë qenë sfidat e përballuara gjatë mësimi *online*?” (edhe këtu të intervistuarit mund të zgjidhnin më shumë se një opsion). Nga përgjigjet e marra vihet re se primare ka qenë aksesin e studentëve në teknologji, e ndjekur nga komunikimi interaktiv dhe mungesa e materialeve të dixhitalizuara dhe faktorë të tjerë sipas renditjes në tabelën në vijim.

Tabela 20: Shpërndarja e pedagogëve të intervistuar sipas sfidave të përballuara

Nr	Sfidat	Nr	Në %
1	Aksesi i studentëve në teknologji	98	20.2
2	Komunikimi interaktiv me studentët	74	15.2
3	Mungesa e materialeve mësimore të digjitalizuara	70	14.4
4	Aksesi në teknologji (kompjuteri, platforma, internet etj)	66	13.6
5	Menaxhimi i kohës dhe organizimi	65	13.4
6	Niveli i ulët i njohurive digjitale i studentëve	62	12.8
7	Orientim/ mbështetje e pakët nga universiteti	26	5.3
8	Niveli i ulët i njohurive digjitale nga ana juaj	25	5.1
Gjithsej		486	100.0

Konkluzione dhe rekomandime

Konkluzione nga informacioni i marrë nga pedagogët

Pyesori iu shpërnda *online* pedagogëve të universiteteve publike dhe private. Nga përgjigjet e marra rezultuan respektivisht 15% nga universiteti i Tiranës dhe Elbasanit, 14.2 nga universiteti i Vlorës dhe 13.3% nga universiteti i Korçës, 15% nga Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë, 14.2% nga Universiteti Luarasi dhe 13.3% nga Universiteti Metropolitan Tirana. Për sa i përket shpërndarjes sipas gjinisë rezultoi se predominojnë pedagogët femra me 68.2% dhe mendojmë se kjo është një strukturë e përafërt me strukturën e pedagogëve në universitete dhe ka lidhje edhe me faktin se në këtë strukturë predominojnë femrat. Për sa i përket moshës u vu re se më shumë se gjysma e tyre janë në moshën 31-50 vjeç dhe vetëm 3.9% janë të moshës mbi 60 vjeç. Kjo strukturë është përfaqësuese e strukturës moshore të pedagogëve në IAL-të publike dhe private në Shqipëri.

1. Mësimi *online* është zhvilluar më tepër në kushte shtëpie.
2. Mësim *online* është zhvilluar për 7-8 orë në javë dhe gjysma e pedagogëve theksojnë se kanë patur pak ose aspak ekperiencia dhe njohuri të mëparshme të mësimit *online*.
3. Ndër vështirësitë kryesore të përballura nga pedagogët ka qenë fakti që në një periudhë të shkurtër ju duhej të përgatishin për mësimin *online* disa lëndë (gati 1/4 e pedagogëve deklarojnë se kanë dhënë 4 ose më shumë lëndë dhe mesatarja rezultoi me 2.8 lëndë). Duhet të kemi parasysh se kemi të bëjmë me shkelje të legjislacionit në fuqi, që thekson se një pedagog nuk mund të jap mbi 3 lëndë gjatë një viti akademik.
4. Ka rritje të njohurive për metodën e mësimit *online* mesatarisht me 55.8%.
5. Udhëzimet e marra nga universitetet vlerësohen në nivelin mesatar dhe po në të njëjtin nivel vlerësohen edhe kuptueshmëria e këtyre udhëzimeve si dhe vështirësia e bërjes së mësimit *online*.
6. Njohuritë nga pedagogët më shpesh janë fituar në mënyrë autodidakte dhe duke bashkëpunuar midis kolegëve dhe tashmë pedagogët ndihen mjaftueshëm të përgatitur për të zhvilluar mësimin *online*. Niveli i vështirësisë vlerësohet në 2.5 (midis e lehtë dhe mesatare) ku 40% e të intervistuarve deklaruan vështirësi mesatare, por vetëm 12% deklarojnë vështirësi të mëdha dhe shumë të mëdha. Pra, nuk ka qenë shumë e vështirë për pedagogët që të abjentohen me mësimin *online* dhe me platformat e përdorura.
7. Nevoja për dixhitalizim është shumë e madhe.
8. Vlerësohet se kjo ka qenë një eksperiencë pozitive, ku vështirësitë vlerësohen si mesatare dhe shumica e pedagogëve do e përdorin mësimin *online* edhe në kushtet e kthimit të mësimdhënies në normalitet. Në mënyrë të natyrshme të intervistuarit janë në favor të metodës së zhvillimit të mësimit në auditor (ballë për ballë me studentët) si metoda më e mirë (60.5%), por jo të paktë janë ata që pëlqejnë edhe alternimin e të dy metodave (27.5%) gjë që tregon se universitetet duhet të marrin masa që me kalimin e kohës edhe alternativa e mësimit *online* duhet të vazhdojë të jetë prezente në mësidhënie në nivele të ndryshme dhe për statuse të ndryshme.

9. Problemet kryesore të zhvillimit të mësimin *online* të paraqitura nga pedagogët janë kalimi për një kohë të shkurtër nga mësimi në auditor në mësimin *online*, fleksibiliteti i ulët, mospërfshirja aktive e studentëve në mësim dhe mbi të gjitha mungesa e kontakteve ballë për ballë me studentët në auditor.
10. Arsyet kryesore të vështirësive janë mungesa e kohës për të organizuar metodologjinë *online*, mungesa e njohurive dhe mungesa e një paisjeje teknologjike.
11. Platforma e përdorur më së shumti ka qenë *Google classroom* dhe pedagogët kanë punuar kryesisht me laptop dhe celular.
12. Në të ardhmen duhet të përmirësohet materialet e punës dhe infrastruktura për zhvillimin e mësimin *online*.
13. Sfidat kryesore të përballura kanë qenë jo vetëm aksesin i studentëve në pasijet teknologjike, por edhe komunikimi interaktiv, mungesa e përgatitjes paraprake dhe menaxhimi i kohës në mësimin *online*.
14. Lidhur me përdorimin e mësimin *online*, 2/3 e pedagogëve të intervistuar mendojnë se do ta përdorin mësimin *online* edhe pas rikthimit në auditore, duke treguar në këtë mënyrë se kjo ishte një eksperiencë me vlerë dhe që do të përdoret si metodë mësimdhënieje alternative edhe në kushtet normale të mësimdhënies. Pra, pedagogët kanë patur se çfarë të mësojnë nga eksperiencia e mësimin *online* dhe nga kombinimi me metodën tradicionale të mësimdhënies në auditore.

Konkluzione nga informacioni i marrë nga studentët

Pyetsorët për studentët u shpërndanë në universitete të ndryshme të vendit, ku pjesa më e madhe ishin studentë të universiteteve publike konkretisht: 58% në universitete publike dhe 42% në universitete jopublike. Pyetsorët u shpërndanë në cikle të ndryshme studimi në këto universitete, ku pjesa më e madhe e studentëve të pyetur ishin pjesë e sistemit *bachelor*, 80% *bachelor* (viti i dytë dhe viti i tretë) dhe 20% në nivel Master.

Pjesa më e madhe e studentëve të përfshirë në studim, 78% e tyre, ishin nga zonat urbane dhe 22% nga zonat rurale. Gjithashtu, rezultoi se 37% e studentëve banonin në bashkinë Tiranë dhe pjesa tjetër e tyre në bashki të tjera të vendit. Afërsisht 59% e tyre vinin nga familje me kryefamiljar të punësuar, 27% e studentëve deklaruan se vinin nga familje me kryefamiljar të papunë dhe rreth 3% e tyre vinin nga familje me kryefamiljar invalid. Mosha mesatare e studentëve të përfshirë në zgjedhje është 20 vjeç.

1. Studentët kanë njohuri të mira në IT, por më shumë se gjysma e studentëve e kanë ndjekur mësimin *online* përmes smartfonëve gjë që ka shkaktuar vështirësi sidomos për mësimin në lëndët e shkencave ekzakte.
2. Aksesin në internet vlerësohet që në shumicën e rasteve të ketë qenë mesatar dhe mbi mesatar. Pjesa më e madhe e studentëve, 67% e tyre, kishin internet wifi apo internet kabllor në shtëpitë e tyre ndërsa pjesa tjetër e siguronin internetin nëpërmjet paketave të internetit nga kompanitë celulare dhe kosto e internetit vlerësohet të ketë qenë mesatarisht rreth 1800 lekë në muaj. 76 % e studentëve

deklaruan se nuk punonin gjatë periudhës së mësimin *online* edhe pse 16 % prej tyre kishin punuar më parë ndërkohë që 14 % e tyre punonin gjatë kësaj periudhe edhe pse nuk kishin punuar më parë.

3. Një problem i paraqitur nga studentët është edhe mungesa në banesat e tyre të një hapësire të qetë për të ndjekur mësimin.
4. Larmishmëria e formave të mësimin ishte e gjerë, por kryesisht përqendrohej në videokonferenca dhe mësimi në mënyrë të pavarur dhe në shumë raste nuk kishte unifikim për mënyrën e mësimdhënies *online* për lëndë të ndryshme.
5. Vlerësimi për efektivitetin e mësimin *online* është i ndryshëm për metoda të ndryshme, ku më pak efektive vlerësohet se ka qenë leximi i pavarur dhe i materialeve shtesë si dhe përdorimi i rasteve studimore.
6. Vështirësitë kryesore që përmenden për mësimin *online* janë cilësia e dobët e internetit, mospërqendrimi gjatë mësimin *online*, kosto e lartë e internetit dhe oraret e papërshtatëshme të zhvillimit të mësimin.
7. Zhvillimi i seminareve gjatë mësimin *online* është bërë jo vetëm drejtpërdrejtë *online* por edhe përmes dërgimit të të detyrave të përgatitura gjë që është disi problematike.
8. Vlerësimi i studentëve për efektivitetin e mësimin *online* është i ulët dhe në shkallën nga 1 në 5 (1 shumë i ulët dhe 5 shumë i lartë) vlerësohet të jetë 2.2, pra efektiviteti i ulët. Krahasuar me mësimin në auditor, pjesa më e madhe e studentëve, 64% e tyre, mendojnë se mësimi *online* është aspak apo pak efektiv krahasuar me mësimin në auditor duke preferuar në këtë mënyrë mësimin në auditor.
9. Po ashtu si pedagogët edhe studentët vlerësojnë se duhen bërë ndryshime në materialet dixhitale dhe në infrastrukturën fizike të mësimdhënies.
10. Ndërthurja e leksioneve me seminarët gjatë mësimin *online* vlerësohet në shkallën nga 1 në 5 me vlerën 2.4, pra një nivel më pak se mesatar.
11. Nxitja e studentëve nga pedagogët për pjesëmarrje aktive në mësimin *online* vlerësohet me 2.3, pra nivel i ulët, ndërkohë që përputhja e tezave të provimit me shpjegimet e dhëna në mësimin *online* vlerësohet disi mbi mesataren (3.2 ndaj 5 që është maksimumi).
12. Si avantazhet kryesore të mësimin *online* janë përmendur mundësia e aksesimit të materialeve në çdo kohë, mundësia e të ndenjurit të shtëpi, mundësia për të regjistruar një mësim si dhe komforti përreth etj., ndërsa si disavantazhet kryesore janë përmendur zvogëlimi i komunikimit me pedagogët, izolimi social, kushte jo të mira studimi në shtëpi, mungesa e disiplinës vetjake etj.

Rekomandime për pushtetin qendror dhe vendor

1. Krijimi i një baze të dhënash të familjeve në nevojë që kanë fëmijë që ndjekin arsimin e lartë dhe mbështetja në mënyra të ndryshme e këtyre familjeve për të përmirësuar kushtet e studimit të fëmijëve në universitet. Kjo mund të bëhet përmes dhurimit të *tablet*-ve ose *laptop*-ëve për të ndjekur mësimin *online* dhe bashkëpunimit me kompanitë që ofrojnë shërbim interneti për të mbuluar një pjesë

të koston së internetit nga ana e shtetit. Kjo gjë mund të bëhet edhe për familjet në nevojë që kanë fëmijë në arsimin parauniversitar.

2. Kontroll më rigoroz ndaj kompanive që ofrojnë shërbim interneti jo vetëm për mbulimin e të gjithë territorit me internet, por sidomos me shërbim cilësor interneti.

Rekomandime për universitetet dhe pedagogët

1. Standartizimi i platformave që përdoren për mësimdhënie, trajnimi i herëpashershëm i stafit akademik për të përdorur këto platforma në të gjithë gamën e mundësive që ato ofrojnë si dhe kontrolli më rigoroz që të mos lejohen pedagogët që të japin pjesën më të madhe të materialeve për studim të pavarur.
2. Gjetja e formave të bashkëpunimit me kompani të ndryshme për të siguruar sponsorizime për pajisje elektronike për studentët nga shtresat në nevojë dhe me kompanitë që ofrojnë shërbim interneti për internet falas ose me çmim të reduktuar për studentët që vijnë nga shtresat në nevojë.
3. Përpjekje më intensive për t'u ambjntuar me kushtet e mësimi *online* dhe pjesëmarrje më aktive të studentëve gjatë mësimi *online*.
4. Bazuar në eksperiencën e fituar, të bëhet rishikimi i të gjitha materialeve që kanë përgatitur gjatë vitit të kaluar akademik duke i përmirësuar ato.
5. Të rishikohen metodat e vlerësimit, të cilat mund të jenë fleksibël, përfshirë prezantimet, projektet në grup, format standarde të testimit *online*, testime të ndryshme, etj.

Rekomandime për studentët

1. Riorganizimi i shpenzimeve që ata bëjnë duke shtuar pjesën e buxhetit të shkollimit për shpenzime për pajisje teknologjike dhe internet dhe duke reduktuar shpenzimet të tjera që nuk janë të domosdoshme.
2. Përpjekje më intensive për t'u ambjntuar me kushtet e mësimi *online* dhe pjesëmarrje më aktive gjatë mësimi *online*.

Referenca

- Albrahim F. (2020). *Online Teaching Skills and Competencies*. The Turkish *Online Journal of Education* volume 19, issue 1, p9-20.
- Ally, M. (2008). Foundations of educational theory for *online* learning. <https://pdfs.semanticscholar.org/330a/4c4486de39800f8603b2e38d32c4dbdc245f.pdf>
- Arkorful, V., & Abaidoo, N. (2015). The role of e-learning, advantages and disadvantages of its adoption in higher education. *International Journal of Instructional Technology and Distance Learning*, 12(1), 29–42.
- Bao, W. W. *COVID-19 and online teaching in higher education: A case study of Beijing University*. *Hum. Behav. Emerg. Tech.* 2020, 1–3.
- Boelens, R., De Wever, B., & Voet, M. (2017). Four key challenges to the design of blended learning: A systematic literature review. *Educational Research Review*, 22, 1-18.
- Coates H., James R., Baldwin R., “A Critical Examination of the Effects of Learning Management Systems on University Teaching and Learning,” *Tertiary Education and Management.*, 2005, vol. 11, issue 1, pp. 19–36.
- Dhawan Sh. (2020), “*Online Learning: A Panacea in the Time of COVID-19 Crisis*”, *Journal of Educational Technology Systems* 2020, Vol. 49(1) 5–22
- Goode, J. (2007). Empowering or disempowering the international Ph. D. student? Construction of the dependent and independent learner. *British Journal of Sociology of Education*, 28(5), 589-603.
- Gamage, D., Fernando, S., & Perera, I. (2014). Factors affecting to effective eLearning: Learners Perspective. *Scientific Research Journal (SCIRJ)*, 2(5), 42-48.
- Hrastinski (2008) *Asynchronous and Aynchronous e-learning*. The Turkish *Online Journal of Education* volume 19, issue 1. <https://er.educause.edu/articles/2008/11/asynchronous-and-synchronous-elearning>
- Huang, R.H., Liu, D.J., Tili, A., Yang, J.F., Wang, H.H., et al. (2020). *Handbook on Facilitating Flexible Learning During Educational Disruption: The Chinese Experience in aintaining Undisrupted Learning in COVID-19 Outbreak*. Beijing: Smart Learning Institute of Beijing Normal University.
- ILO (2020), *Youth & Covid-19*. “Impact on Jobs, Education, Rights and Mental Well-being”. https://www.ilo.org/global/topics/youth-employment/publications/WCMS_753026/lang-en/index.htm
- Kemp N., Grieve R. (2014), “Face-to-face or face-to screen? Undergraduates’ opinions and test performance in classroom vs *online* learning”. *Frontiers in Psychology/Educational psychology*. <https://pdfs.semanticscholar.org/0a17/3c8670076e3bb3d00d55f2e4374a4b02e5fe.pdf>
- Littlefield, J. (2018). The difference between synchronous and asynchronous distance learning. <https://www.thoughtco.com/synchronous-distance-learning-asynchronousdistance-learning-1097959>
- Liu, C.-H(2010),”The comparison of learning effectiveness between traditional face-to-face learning and e-learning among goal-oriented users, in *Digital Content, Multimedia Technology and its Applications (IDC)*”, 6th International Conference on Digital Content, Multimedia Technology and its Applications -255 - 260

- O'Donoghue, J. et al (2004) *A comparison of the advantages and disadvantages of IT based education and the implications upon students*. Interactive Educational Multimedia, number 9 (November 2004), pp. 63-76
- Schleicher, A. and F. Reimers (2020), *Schooling Disrupted, Schooling Rethought: How the COVID-19 Pandemic is Changing Education*, OECD, https://read.oecdlibrary.org/view/?ref=133_133390-1rtuknc0hi&title=Schooling-disruptedschooling-rethought-How-the-Covid-19-pandemic-is-changing-education (accessed on 13 Nov, 2020).
- Schleicher, A (2020), *The impact of COVID-19 in education .Insight from education at a glance 2020*, OECD <https://www.oecd.org/education/the-impact-of-Covid-19-on-education-insights-education-at-a-glance-2020.pdf>
- Ministry of Education and Religious Affairs (2020), *Mathainoume sto spiti [We learn at home]*, Ministry of Education and Religious Affairs, Greece, <https://mathainoumestospiti.gov.gr/> (accessed on 13 nov 2020).
- Ministère de l'Éducation Nationale et de la Jeunesse (2020), *Ma classe à la maison: mise en oeuvre de la continuité pédagogique [My class at home: Implementing educational continuity]*, Ministère de l'Éducation Nationale et de la Jeunesse, France, <https://www.education.gouv.fr/ma-classe-la-maison-mise-en-oeuvre-de-la-continuitepedagogique-289680> (accessed on 13 Nov 2020).
- MARS & ASCAP. (2020a). Sonazhi i Mesimit *Online 1*. Tirane: MARS & ASCAP. Retrieved from <https://arsimi.gov.al/sondazhi-i-mesimit-online/>
- MARS & ASCAP. (2020b). Sontazhi i Mesimit *Online 2*. Tirane: MARS & ASCAP. Retrieved from <https://arsimi.gov.al/sondazh-i-mesimit-online-2/>
- Petrie, C., Aladin, K., Ranjan, P., Javangwe, R., Gilliland, D., Tuominen, S., & Lasse, L. (2020). Spotlight: Quality education for all during COVID-19 crisis. Hundred. Retrieved from [https:// hundred.org/en/research](https://hundred.org/en/research)
- UNESCO. (2020, May 4). Empowering students with disabilities during the COVID-19 crisis. Retrieved from UNESCO Bangkok Asia and Pacific Regional Bureau for Education: <https://http://supporthere.org/news/influence-Covid-19-teaching-albanian>
- Zhang, D., Zhao, J., & Zhou, L. (2004), "Can E-learning replace classroom learning?", Communications of the ACM, vol.47.
- WORLD VISION (2020). Impact assessment of the COVID-19 outbreak on wellbeing of children and families in Albania. Marrë nga https://www.wvi.org/sites/default/files/2020-06/COVID_Assesment_Report_WVA_final.pdf